



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Bioteknologji”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asoc. Rozeta Hasalliu
2. Prof. Asoc. Valbona Kolaneci

Dhjetor, 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bsc në "Bioteknologji"

Nr.		
1.	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2.	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Bioteknologjisë
3.	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Bioteknologjisë"
4.	Urdhëri/VKM i licensimit:	VKM Nr. 976, datë 08.10.2009
5.	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH Nr. 297, datë 20.07.2012
6.	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7.	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
8.	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
9.	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
10.	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11.	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
12.	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14.	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15.	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	30 PAE / 17 PAK
16.	Numri i studentëve:	295 studentë
17.	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; 200 - 400 fjalë

Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hapur me VKM Nr. 976, datë 08.10.2009. Regjistrimi i formës së diplomës për këtë program studimi është realizuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 297, datë 20.07.2012. Ky proces akreditimi është akreditimi i tij i parë.

Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është i organizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai shtrihet në 3 vite studimi/6 semestra, me gjithsej 180 kredite, në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky program synon krijimin e specialistëve në fushat madhore të bioteknologjisë: agrobioteknologji, bioteknologji mjekësore e farmaceutike, bioteknologji mjedisore dhe bioteknologji ushqimore.

Programi është hartuar në përputhje me direktivat për ruajtjen, konsolidimin dhe avancimin e vlerave akademike kombëtare me synim implementimin e teknologjive të avancuara në shërbim të ekonomive vendore. Në këtë kuptim, tradita dhe e reja, bashkëjetojnë në shërbim të interesave kombëtare për zhvillim.

Programi ofrohet nga Departamenti i Bioteknologjisë, njësi bazë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, i cili konsideron si mision në mënyrë specifike përputhjen e fushave studimore të tij me interesat kombëtare të zhvillimit ekonomik, dedikuar natyrës së bioteknologjisë, si shkenca të lidhura ngushtë me industrinë ushqimore, bujqësinë, mjekësinë e farmaceutikën, mjedisin, mbrojtjen nga rreziqet, etj. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbëhet nga 10 staf akademik efektiv, me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 4 Prof. As., 3 Dr., dhe 1 Msc.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i cili u përzgjedh për vlerësimin e këtij programi përbëhet nga Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu dhe Prof. Asoc. Dr. Valbona Kolaneci, shoqëruar nga Koordinatorët Teknikë të ASCAL Z. Erion Xhako dhe Zj. Ersi Dako.

Raporti i vlerësimit të jashtëm u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni pranë ASCAL, vizitën e realizuar në Institucion në datat 7-8 Korrik 2022, si dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar gjatë vizitës në Institucion.

Në bazë të Agjendës së vizitës të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Vlerësimin dhe Akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” të miratuar nga të gjitha palët e përfshira në proces, u realizuan takime të planifikuara me: Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit; Grupin e Vlerësimit të Brendshëm; Stafin akademik të programit; Studentët e programit; Zyrën e Kurrikulave; Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës; Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë; Degën e Burimeve Njerëzore; Sekretarinë Mësimore, si dhe u vizituan mjediset e Institucionit (auditorët, laboratorët, shërbimet për studentët, biblioteka, etj.).

GVJ në këtë raport ka paraqitur vlerësimin e tij sipas standardeve shtetërore të cilësisë dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji”.

Më datë 02.11.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/138 Prot., datë 02.11.2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 17.11.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 2801/11 Prot., datë 18.11.2022.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-Raportin, sqaron si në vijim:

1. **GVJ tek Standardi IV.1, Kriteri 3:** GVJ nuk mund të gjykojë për objektivitetin e punësimit të stafit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji”, pa u njohur fillimisht me kriteret e vlerësimit të dosjeve të aplikantëve në kohën e rekrutimit të tyre, por nga shqyrtimi i dy dosjeve të personelit akademik të ruajtura në Degën e Burimeve Njerëzore FShN, e të zgjedhura në mënyrë rastësore, u vërejt se arritjet akademike universitare të tyre ishin të një niveli mesatar.

Komenti nga IAL: GVB për Departamentin e Bioteknologjisë pretendimin e mësipërm e konsideron të pabazë pasi siç është evidentuar prej tyre, nuk kanë njohje të kriterëve të vlerësimit të dosjeve të aplikantëve. Në këtë kuptim vërejtja sipas së cilës arritjet akademike të stafit të punësuar ishin të një niveli mesatar, është e pabazuar. Më specifikisht, në 4 vitet akademike për të cilat është kërkuar akreditim, Departamenti i Bioteknologjisë ka rekrutuar si staf të brendshëm vetëm Prof.As. R.SH., me mesatare të studimeve universitare 9.78 dhe gradat e titujt Doktor dhe Profesor i Asociuar.

Komenti nga GVJ: GVJ nuk ka hulumtuar rreth rasteve specifike të rekrutimit të stafit, ai ka verifikuar, mbështetur në evidencat e paraqitura nga IAL dhe takimin me specialistët e Zyrës së Burimeve Njerëzore, FShN, procedurën e rekrutimit të stafit akademik, përmbajtjen e dosjes personale të pedagogut dhe mënyrën e përditësimit të saj. Për të verifikuar përmbajtjen dhe cilësinë e dosjes u përzgjedhën në mënyrë rastësore, e theksojmë me short, jo në mënyrë preferenciale, dy dosje të pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie në programin Bachelor në Bioteknologji. Kjo përzgjedhje nuk i referohet stafit të rekrutuar në 4 vitet e fundit, por stafit të përfshirë në mësimdhënie në këtë program, pavarësisht kohës dhe kushteve në të cilat është punësuar ai. Nga shqyrtimi i këtyre dosjeve rezultoi se arrijtjet akademike të nivelit Bachelor të tyre ishin të nivelit mesatar. Së pari, nuk gjykojmë procesin e rekrutimit të tyre, sepse siç e kemi përmendur në raport, nuk jemi njohur me dosjet e aplikantëve të tjerë dhe kriteret e kohës, megjithëse mendojmë se kriteri i arrijtjeve akademike është kriteri kryesor përzgjedhës i stafit akademik në çdo kohë. Së dyti, nuk diskutojmë vendimin e komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve dhe nuk gjykojmë për meritokracinë e kandidatëve të përzgjedhur ndaj kandidatëve të tjerë. Ajo çfarë është shkruar në RVJ është konstatimi i GVJ se dy dosjet, që u shqyrtuan, rezultuan me arritje akademike te nivelit mesatar në ciklin e I-rë të studimeve. Për arsye etike dhe të ruajtjes së privatësisë, dosjet e shqyrtuara nuk përmenden me emër në RVJ. Së treti, kjo gjetje nuk përjashton faktin se DBT ka lektorë me arritje të larta akademike dhe kërkimore, dhe se në përgjithësi, për gjithë stafin këto arritje janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme përmes kualifikimeve të ndryshme. Shembulli specifik, të cilit i referohet IAL nuk e zhbën gjetjen e GVJ. Mbështetur në këtë konstatim, GVJ mendon se Kriteri 3 (Standardi IV.1) përmbushet, por jo plotësisht. Për sa më lart, gjykimi i GVJ nuk ndryshon.

2. **GVJ tek Standardi IV.1, Kriteri 4:** Kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve gjykojmë që nuk duhet të jenë aq “specifike”, në kushtet kur dihet se në Shqipëri numri i specialistëve në fusha shumë specifike e me një përvojë të caktuar kohore në fushën e caktuar është shumë i vogël, për të mos thënë është vetëm një. Edhe për këtë arsye, kriteret specifike nuk duhen konsideruar kritere preferenciale, sepse kjo përjashton nga konkurimi kandidatët me arritjet më të mira akademike. Respektimi i Statutit, rregulloreve të UT në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit të stafit akademik me kohë të plotë apo me kontratë, stafit ndihmës akademik e administrativ si dhe kontrolli i respektimit të kritereve dhe procedurave në punësimin e stafit të DBT do të siguronte përzgjedhjen e personelit me kualifikimin më të mirë në përputhje me natyrën e vendit të punës, përmbajtjen e programit të studimit dhe lëndën/lëndët specifike.

Komenti nga IAL: GVB gjykon se pretendimi i mësipërm bie ndesh me Statutin dhe Rregulloret e rekrutimit të UT, FSHN, pasi pikërisht nevoja për staf të kualifikuar në mënyrë specifike, në përputhje me disiplinat dhe modulet e programit BSH në Bioteknologji, është ajo që duhet kryer në kushtet e IAL në Shqipëri, për një cilësi më të mirë të mësimdhënies e kërkimit shkencor, e në përputhje me natyrën e vendit të

punës. Për më tepër, GVJ nuk sqaron se cili/at kritere të procedurave të punësimit apo kontrollit janë shkelur, duke e lënë vlerësimin evaziv.


Komenti nga GVJ: Në shembullin e një procedure rekrutimi të stafit akademik me kohë të plotë, të dhënë nga GVJ si evidencë, janë prezantuar edhe kërkesat për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përzgjedhjes së kandidatëve. Si kritere të veçanta janë vendosur: “Preferohen kandidatë që kanë përvojë pune në Citologji-Citogjenetikë për 10 vjet dhe përvojë pune si lektor në IAL mbi 10 vjet”. GVJ nuk gjykon punën e komisionit përzgjedhës, apo meritokracinë e kandidatit të përzgjedhur, por procedurën. Konkretisht, për GVJ, kriteret specifike të vendosura nga DBT janë shumë specifike, të cilat, kur janë preferenciale, mund të shpien në përjashtimin e kandidatëve me arritjet më të larta akademike. Sa është numri i specialistëve shqipfolës me përvojë mbi 10 vjet në fushën e Citologji-Citogjenetikës dhe me përvojë mësimdhënie mbi 10-vjeçare në një IAL? Sa nga aplikuesit i përbushnin të gjitha kriteret e përgjithshme dhe ato specifike, që nga ata të përzgjidhet ai me arritjet më të larta? Në “Manualin mbi punësimin e personelit në UT” shprehet shqetësimi për “përcaktimin jo të saktë të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të propozuara nga njësia kryesore/njësia bazë” dhe për “trajtimin e kriterëve të veçanta si kritere preferenciale”, e për këtë arsye kërkohet vlerësimi dhe miratimi i kriterëve specifike në nivelin e njësisë bazë, e vërtetuar kjo me proces verbal mbledhje, përpara se ato të miratohen nga Dekani dhe Rektori. Për sa më lart, gjykimi i GVJ nuk ndryshon.

3. **GVJ tek Standardi IV.2, Kriteri 4:** Nga numri i madh i pedagogëve të angazhuar me kontratë, të bie në sy numri po ashtu i madh i pedagogëve pa gradë shkencore. Për vitin akademik 2021-2022 nga 17 pedagogë me kontratë të angazhuar në programin e studimit, 9 janë pa gradë shkencore, vetëm me studimet universitare të nivelit master shkencor. Disa prej pedagogëve me kontratë angazhohen në mësimdhënie me një numër të vogël orësh (më pak se 30). GVJ gjykon se do të ishte në favor të cilësisë angazhimi i më pak pedagogëve, me normë më të lartë (deri në 140 orë të lejueshme) dhe me kualifikim më të lartë.

Komenti nga IAL: GVB në përgjigje të pretendimeve të mësipërme informon GVJ se pasja e gradave dhe titujve nuk është kriter ligjor për rekrutimin e stafit të ftuar, i cili specifikisht në programin BSH në Bioteknologji është punësuar për të mbuluar kryesisht praktika laboratorike. Meqënëse stafi i brendshëm ka ngarkesë maksimale mësimore, është vendosur që pedagogët e ftuar të mbulojnë praktikat laboratorike sipas nevojave të lëndëve, me një numër orësh që varion sipas përcaktimit ligjor deri në 120 orë mësimore (jo 140 orë). Theksojmë se nga aplikantët janë zgjedhur më të mirët dhe të duhurit për nevojat e departamentit. Vetëm një pedagog i ftuar nga 17 të tillë ka ngarkesën 28 orë mësimore pasi disiplina me zgjedhje ka këtë numër orësh, gjithsej. Në këtë kuptim, pretendimet e GVJ nuk kanë bazë ligjore, ndaj kërkohet të rishikohen nga GVJ.

Komenti nga GVJ: Mbështetur në evidencat 1.25 dhe 3.14 (shtesa), për vitin akademik 2021-2022, GVJ ka evidentuar se nga 17 me kontratë të përfshirë në

mësimdhënie në programin Bachelor në Bioteknologji, 9 janë rekrutuar nga DBT për lëndët ose modulet që ofrohen nga ky departament për këtë program me orë auditori që variojnë nga 28 në 120. Raporti pedagogë me kontratë/pedagogë efektivë është 0.9, pra gati për çdo pedagog efektiv ka edhe një pedagog me kontratë. Nisur nga kjo, GVJ sugjeron se lëndë të vogla me pak orë (28 orë) mund të shpërndahen në ngarkesën e stafit të brendshëm, më konkretisht në ngarkesën e titullarit të lëndës (me titull Prof. apo Prof. As.), dhe se do të ishte në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, zgjerimi i kapacitetit akademik të DBT me staf të brendshëm dhe kufizimi i numrit të stafit akademik me kontratë duke rritur orët e ngarkesës së stafit të brendshëm, brenda kufizimeve ligjore. Megjithatë, GVJ merr parasysh komentimin e IAL-së, riformulon këtë paragraf në standard, sikurse shprehur më lart dhe për rrjedhojë ndryshon vlerësimin për standardin dhe fushën.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Bioteknologji”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti i Tiranës kanë si mision jo vetëm formimin e specialistëve në fushat përkatëse, por edhe të qytetarëve të denjë që do të kontribuojnë në zhvillimin e vendit dhe të standardeve të demokracisë. Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” përmbush kërkesat e Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore, dhe është në mbështetje të strategjisë së zhvillimit të UT dhe të Departamentit të Bioteknologjisë (DBT). <i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.5).</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në statutin e UT dhe në dokumentat strategjike të UT dhe DBT nënvizohet ruajtja dhe konsolidimi dhe zhvillimi i vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Këto vlera transmetohen në mënyrë të natyrshme tek studentët të ndërthurura me informacionin shkencor, nëpërmjet programeve të studimit që ofrohen nga DBT, përfshirë edhe programin e ciklit të parë të studimeve në “Bioteknologji”. <i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.3; Evidenca 1.5).</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, misionin, qëllimin dhe objektivat e UT dhe ato të FSHN. Programi i studimit që ka si qëllim kryesor formimin bazë të specialistëve në fushën e bioteknologjisë është plotësisht në përputhje me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UT dhe strategjinë e DBT. <i>(Evidenca 1.2; Evidenca 1.5; Evidenca 1.7).</i>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Në Planin Strategjik të Zhvillimit të UT përcaktohet synimi për ofrimin e programeve mësimore në përputhje me interesat e zhvillimit ekonomik kombëtar. Në mbështetje të plani strategjik zhvillimit të UT dhe të DBT, programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji”, nëpërmjet objektivit të përgatitjes së specialistëve me dije bashkëkohore në fushën e bioteknologjisë, synon përparimin ekonomik kombëtar dhe lokal. <i>(Evidenca 1.2; Evidenca 1.5; Evidenca 1.7).</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hartuar në mbështetje dhe zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të UT 2018-2023, Strategjisë së DBT 2018-2023 si dhe në zbatim të kërkesave të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë në UT. Në zbatim të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë në UT, diploma Bachelor në “Bioteknologji” përmbush objektivat dhe rezultatet e të nxëniet si dhe përputhet me nivelin e kornizës kombëtare të kualifikimeve¹.</p> <p><i>(Evidenca 1.2; Evidenca 1.5; Evidenca 1.13).</i></p>		
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e UT. Ai mbështet drejtimit prioritar në lidhje me mësimdhëniën dhe studimet të shprehura në Kreun I të Strategjisë së Zhvillimit të UT.</p> <p>Objektivat akademike dhe kërkimore të këtij programi studimi, të sanksionuar në Rregulloren e tij janë në funksion të prioritetëve akademike të UT.</p> <p><i>(Ligji 80/2015; Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.4; Evidenca 1.7).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” është plotësisht në përputhje me fushën akademike që mbulon FShN dhe specifiku me fushën që mbulon Departamenti i Bioteknologjisë dhe plotëson kërkesat e sanksionuara në Nenet 89, 103 dhe 104 të Statutit të UT.</p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Bioteknologji” përmban elemente të hollësishme që rregullojnë procesin mësimor në këtë program studimi në përputhje me Nenin 71, 73 dhe 74 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidencat 1.5-1.8).</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

¹ Ligji nr.10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve” https://finans.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010_korniza_shqiptare_e_kualifikimeve.pdf

Standardi I.3**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” janë të përcaktuara objektivat formuese për të diplomuarit në këtë program dhe aftësitë formuese të tyre në përfundim të studimeve. Në funksion të këtyre objektiveve formuese është hartuar edhe programi mësimor.</p> <p>Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, si dhe mundësitë për studime të mëtejshme janë të pasqyruara edhe në suplementin e diplomës së këtij programi studimi.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.8; Evidenca shitesë 2.6).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Si UT ashtu edhe DBT janë angazhuar në studimin e tregut të punës për të diplomuarit përkatësisht në FShN dhe më specifikisht për të diplomuarit në programet e studimit të ofruara nga DBT. Bazuar në analizën e tregut të punës, kryer nga UT për të diplomuarit në FShN, programet e studimit që ofrohen nga FShN i janë përshtatur kërkesave të tregut të punës. Në raportin e UT (miratuar në 2018) jepen statistika punësimi vetëm për studentët e diplomuar në nivelin e dytë të studimeve. Në raportin e gjurmimit të studentëve të hartuar në vitin 2021, pas diplomimit në Bachelor në “Bioteknologji”, mbështetur në intervistat e studentëve të diplomuar nga viti 2009 e në vazhdim, del se vetëm 6 % e të diplomuarve në ciklin e parë të studimeve nuk vazhdojnë studimet e mëtejshme. Në raport nuk del e qartë, nëse statistikat e punësimit të prezantuara në evidencën 1.17 i takojnë vetëm të diplomuarve në Master apo ato përfshijnë edhe të diplomuarit në Bachelor. Nga takimi me pedagogë të Departamentit të Bioteknologjisë u sqarua se shumica e të diplomuarve të nivelit të parë të studimeve në Bioteknologji vazhdojnë direkt studimet Master, kryesisht në programet e ofruara nga Departamenti. Një pjesë e vogël e studentëve, që i takon kryesisht atyre me rezultate më të dobëta, e kanë të vështirë punësimin në profesionin e bioteknologut. <i>Shfrytëzimi i metodave të tjera të gjurmueshmërisë, përveç anketimeve, si edhe analiza e arsyeve të nivelit të ulët të punësimit të të diplomuarve në Bachelor në profesionin e tyre, do të ndihmonte në përmirësimin dhe përshtatjen e programit të studimit sipas kërkesave të tregut të punës.</i></p> <p>Në mënyrë që të sigurohen të dhëna të mjaftueshme e të vazhdueshme mbi punësimin e të diplomuarve dhe nevojat e tyre për trajnime të mëtejshme, UT ka ngritur rrjetin ALUMNI. Ky rrjet jo vetëm që mundëson sigurimin e të dhënave mbi punësimin, por ai ndihmon, nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe ndihmës në aplikim, edhe në punësimin e të diplomuarve.</p> <p><i>(Evidenca 1.10; Evidenca 1.16.3; Evidenca 1.17; Vizita ne Institucion, takimi me pedagogë të Departamentit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të</p>	<p>Objektivat formuese të programit Bachelor në “Bioteknologji” janë përcaktuar qartë në Rregulloren e programit të studimit, por nga data që</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 10


<p>nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>mban (29.12.2021) duket se ajo do të hyjë në fuqi në vitin akademik 2022-2023.</p> <p>Struktura e programit mësimor/kurrikulës dhe përmbajtja e programeve të lëndëve, ndryshimet e programit dhe të syllabuseve për t'ju përgjigjur zhvillimeve shkencore në vend dhe botë dhe kërkesave të tregut të punës, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathësive e kompetencave për t'ju përgjigjur nevojave të tregut të punës.</p> <p><i>Meqenëse programi i studimit Bachelor në "Bioteknologji" është një program teknologjik, do të propozonim kryerjen e praktikës profesionale, si lëndë plotësuese, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Ky propozim mbështetet në faktin se jo të gjitha shprehjet në fushën e bioteknologjisë mund të fitohen në laborator. Praktika profesionale, p.sh. në industrinë farmaceutike, ushqimore, të trajtimit të mbetjeve të ngurta, të ujërave të zeza, etj., do të rrishte aftësitë praktike të studentëve dhe t'i përshtaste ata më lehtë në tregun e punës pas diplomimit. Një kërkesë e tillë erdhi edhe nga vetë studentët e nivelit Bachelor të studimeve në Bioteknologji.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.7-1.9; Evidenca 6.7; RVB, Aneks, Tabela 11; Takimi me studentët e programit).</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 840 805 913">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="805 840 1024 913">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1024 840 1236 913">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1236 840 1444 913">Nuk përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 913 805 958"></td> <td data-bbox="805 913 1024 958"></td> <td data-bbox="1024 913 1236 958" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1236 913 1444 958"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Nuk përmbushet			X	
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Nuk përmbushet						
		X							

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi Bachelor në "Bioteknologji" ofrohet që nga viti akademik 2009-2010 nga Departamenti i Bioteknologjisë, departament që u krijua në vitin 2008 mbi bazën e stafit kërkimor dhe infrastrukturës laboratorike të ish-Institutit të Kërkimeve Biologjike.</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022², Departamenti i Bioteknologjisë përbëhej nga 10 staf akademik efektiv, me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 4 Prof. As., 3 Dr., dhe 1 Msc., 16 staf akademik me kontratë, me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 9 Msc, si dhe 5 personel ndihmës akademik.</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022³ u përfshinë në mësimdhënie në këtë program studimi 30 staf akademik efektiv, me kualifikimin: 8 Prof. Dr., 5 Prof. As., 14 Dr., dhe 3 Msc., si dhe 17 staf akademik me kontratë, me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 3 Prof. As., 3 Dr., dhe 9 Msc.</p> <p>Shumica e lektorëve dhe asistentë lektorëve kanë formimin, kualifikimin dhe arrijtet akademike të përshtatshme për lëndën dhe elementët mësimorë të lëndës (leksione, laboratore, seminare, praktika mësimore, etj.), që ata mbajnë.</p>

² Të dhënat për njësinë bazë janë paraqitur sipas evidencës 1.20 shtesë, të marrë gjatë vizitës në Institucion.

³ Të dhënat për stafin akademik të programit janë paraqitur sipas evidencës 1.25 shtesë (tabela 6.4), të marrë gjatë vizitës në Institucion.

	<p>Stafi ndihmës akademik i DBT ka gjithashtu formimin dhe kualifikimin e përshtatshëm për përgatitjen e punëve laboratorike dhe asistimin e studentëve gjatë zhvillimit të tyre.</p> <p><i>(RVB, Aneks, Shtesa 2021-2022, Tabela 6.4; Evidenca 1.20; Evidenca 1.24; Evidenca 1.25; Evidenca 2.2; Evidenca 2.21; Evidenca 3.13; Takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore).</i></p>		
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FShN. Kjo përcaktohet edhe në rregulloren e DBT dhe Rregulloren e Programit të Studimit. <i>FShN-së i mungon një rregullore studimesh, megjithëse është detyrim i sanksionuar në nenin 12, pika a, të Statutit të UT, sipas të cilit, veprimtaria e fakultetit mbështetet ndërmjet të tjerash edhe në rregulloren e fakultetit. Nga takimi me Dekanin dhe Zv. Dekanin për Shkencën të FShN mësuam se ajo është duke u përgatitur.</i></p> <p>Diploma universitare e studimeve Bachelor në “Bioteknologji” kategorizohet në nivelin e gjashtë të kualifikimit, sipas Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve dhe sipas nenit 73, paragrafi 1 të “Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe lejon, mbështetur në kriteret e përcaktura të pranimit, studimet e mëtejshme në programet e ciklit të dytë.</p> <p>Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit është hartuar mbështetur në kuadrin ligjor mbi organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe sigurimin e cilësisë sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.</p> <p><i>(Evidenca 1.6; Evidenca 1.7; Evidenca 2.1; Evidenca 2.16; Takimi me Dekanin, Zv. Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Bioteknologjisë sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit mbështetur në direktivat dhe dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo është e shprehur në Rregulloren e Departamentit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” ka program mësimor të ngjashëm me programe studimi të ciklit të parë analoge në universitete jashtë vendit, duke mundësuar në këtë mënyrë transferimin e krediteve/studimeve ndërmjet universiteteve.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.6; Evidenca 1.7; Evidenca 2.1; Evidenca 2.11.1-2.11.3; Evidenca 2.11.5; Evidenca 5.9; RVB, Aneks, Tabela 9).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda IAL (UT), njësisë kryesore (FShN) dhe njësisë bazë (DBT) në kuadrin e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” rregullohen nëpërmjet dokumentave bazë të këtyre njësive. DBT është përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji”. FShN nëpërmjet Dekanatit dhe DBT nëpërmjet drejtuesit të Departamentit gjithashtu bashkërendojnë dhe ndajnë detyrat ndërmjet personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në kuadër të administrimit të programit të studimit.</p> <p>Procesi i mësimdhënies në këtë program mbulohet në pjesën më të madhe nga stafi akademik i FShN. Koordinimi midis departamenteve të FShN, por edhe të departamenteve në fakultete të tjera të UT në kuadër të programit të studimit, kryhet nga njësia bazë, që e ofron programin (DBT) në bashkëpunim me Dekanatin e FShN. Departamenti propozon kuotat dhe kriteret specifike të pranimit, të cilat miratohen nga Dekani dhe Rektori.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidenca 1.6; Evidenca 1.7; Evidenca 1.11; Evidenca 1.16; Evidenca 1.25; Evidenca 1.26; Evidenca 3.4; Evidenca 3.8; Evidenca 3.10; Evidenca 6.1; Evidenca 6.3; Evidenca 6.4; RVB, Anekse, Tabela 6).</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për të përmbushur misionin dhe objektivat e përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” FShN dhe DBT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me IAL homologe brenda dhe jashtë vendit në kuadër të programeve të bashkëpunimit akademik dhe shkencor. Gjithashtu, UT, FShN dhe DBT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe agjenci shtetërore e publike, kompani private dhe OJF. Kështu, marrëveshje janë lidhur me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Mitrovicës, Universitetin e Hohenheim-it, Gjermani, Muzeun Hungarez të Historisë së Natyrës, Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Shoqatën për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, etj.</p> <p>Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar DBT ka përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit shkencor me Programin Erasmus⁴, nëpërmjet të cilave UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit (2015-vazhdim).</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidencat 1.29-1.31; Evidenca 2.14; RVB fq. 11).</i></p>

⁴ <https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DBT në raportet vjetore të analizës së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore analizon edhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimit që ai ofron. Informacioni dhe gjetjet e këtyre raporteve të njësisë bazë përfshihen në raportet e analizës së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të FShN. Si indikatorë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ndër të tjera janë mobilitetet e studentëve, mobilitetet e personelit akademik; publikimet dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore e stafit akademik, si edhe punimet e diplomave të studentëve. Edhe këto informacione janë të prezantuara në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në FShN. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karierrës (DSBCK) në nivel të FShN gjithashtu përgatit raporte vjetore, në të cilat pasqyrohen analizat mbi ndikimin e mundshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit akademik dhe kërkimor në përmbushjen e objektivave të programeve të ndryshme të studimit. <i>(Evidenca 1.22; Evidenca 1.27; Evidenca 1.32; Evidencat 1.29-1.31; RVB, fq.12).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” nuk parashikon praktika profesionale. Ndërsa për kryerjen e praktikave mësimore për lëndë specifike, UT/FShN/DBT ka marrëveshje me agjenci shtetërore e publike, si edhe kompani private, etj., të cilat mundësojnë kryerjen e praktikave mësimore. Ndër këto mund të përmendim: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Pogradec, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Elbasan, Klegen sh.p.k., Stefani & Co Sh.A, etj. <i>(Evidenca 1.30; Evidenca 1.31; RVB Shtojca, Tabela 5, fq.27).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>DBT ka organizuar dhe synon ta vijojë zhvillimin e shkollën Europiane të Bioteknologjisë (Eurobiotech School) në bashkëpunim me EBTNA dhe MAGI Group, e cila ofron trajnim teorik dhe praktik të të interesuarve në fushat e bioteknologjive të aplikuara⁵. Kjo marrëveshje ka sjellë cilësi të lartë të bashkëpunimit dhe mundësi për trajnime të mëtejshme të studentëve. Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit pranë UT ofron trajnime, seminare dhe leksione të hapura me tematika të ndryshme të dedikuara për stafin akademik, ndihmës akademik, studentë dhe të diplomuar. <i>(Evidenca 2.13; Evidenca 2.13.1; Evidenca 3.12; RVB, fq. 12).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

⁵ <https://sites.google.com/fshn.edu.al/ebs/aim-and-scope>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është i organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 si dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018.</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi të ciklit të parë Bachelor në “Bioteknologji” është 60 ECTS, duke përbërë kështu 180 ECTS në total, për një kohëzgjatje normale të studimesh tre vite akademike, sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 73, pika 1.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 2.1-2.4; Evidenca 2.1.1).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Ky program synon krijimin e specialistëve në fushat madhore të bioteknologjisë: agrobioteknologji, bioteknologji mjekësore e farmaceutike, bioteknologji mjedisore dhe bioteknologji ushqimore përmes formatimit të tyre në vitin e parë në disiplina bazë të shkencave të natyrës (Matematikë, Fizikë, Kimi, Citologji, Fiziologji Bimore dhe Shtazore, etj.) për të kaluar në vitin e dytë ku disiplina karakterizuese (Biologji Molekulare, Kultura Indore të Bimëve, Mikrobiologji, Gjenetikë e Përmirësimit, Biokimi e Metabolizëm Sekondar, etj.) i orientojnë studentët drejt vitit të tretë me lëndë specifike për bioteknologjinë si: Inxhinieria Gjenetike, Bioteknologji Mjekësore dhe Farmaceutike, Imunologji, Inxhinieri e Akuakulturës, Bioteknologji Ushqimore etj. Këto janë të pasqyrura qartë në programin, syllabuset dhe planin mësimor.</p> <p><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 2.1).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Studentët të cilët ndjekin programin e studimit “Bioteknologji” pajisen me njohuritë e duhura në fushën e Bioteknologjisë ku përfshihen dhe të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji”, tek misioni i programit dhe qëllimi e objektivat, sqarohen të gjithë elementët</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 15

	<p>që ofron programi në formimin e studentëve dhe mundësitë për përdorimin e tyre në favor të punësimit. Të gjitha këto pasqyrohen gjithashtu në syllabuset e disiplinave në seksionin “Aftësitë me të cilat pajiset studenti” si dhe tek seksioni “Literatura bazë dhe ndihmëse” e përditësuar nga titullarët e lëndëve. Gjithashtu departamenti i Bioteknologjisë ka nënshkruar shumë marrëveshje me Institucione, për ti mundësuar studentëve njohuritë e duhura për punësimin e tyre pas përfundimit të këtij programi.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.9; Evidenca 1.30).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Bioteknologji” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën akademike dhe profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e Bioteknologjisë. Studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë “Bioteknologji zhvillojnë njohuri teorike dhe praktike të avancuara në të gjitha drejtimet kryesore të bioteknologjisë. Në këtë kuptim, studentët aftësohen për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushat e bioteknologjisë bujqësore, mjekësore dhe farmaceutike, ushqimore dhe asaj mjedisore.</p> <p><i>(Evidenca 1.9).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe VKM Nr. 879, dt. 21.04.2019.</p> <p>Struktura e planit përfshin disiplina të formimit të përgjithshëm dhe të disiplinave të fushës së studimit, të kategorizuara në lëndë bazë 17 % (30 kredite), karakterizuese 53% (96 kredite), ndërdisiplinore 15% (27 kredite), plotësuese 10 % (18 kredite), përmbyllëse 5 % (9 kredite). Kjo shpërndarje e lëndëve në përqindje është në përputhje me përqindjet e lëndëve të përcaktuara nga VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar, e cila përcakton lëndë bazë (15-20%), karakterizuese (50-55%), ndërdisiplinore (12-15%), plotësuese (10-15%), përmbyllëse (3-5%).</p> <p><i>(Evidenca 1.8 shtesë marrë gjatë vizitës).</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai shtrihet në 3 vite studimi /6 semestra, me gjithsej 180 kredite, sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015, neni 73, pika 1.</p> <p>Programi i studimit është i strukturuar në grup lëndësh sipas kategorive të formimit, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor të sipërpërmendur si dhe të reflektuara në programet (syllabus-et) lëndore sipas programit mësimor. Grupimi i lëndëve sipas kategorive formuese është në përputhje me përqindjet e lëndëve të përcaktuara nga VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar dhe përmbushen të gjithë intervalet e përqindjeve të përcaktuara në këtë VKM mbi shpërndarjen e krediteve</p>





	midis kategorive të ndryshme. (Evidenca 1.8 shtesë marrë gjatë vizitës).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Në bazë të Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25, pika 4, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Në këtë njësi ka 10 anëtarë staf akademik efektiv, ku 9 prej tyre janë me tituj akademikë dhe grada shkencore.</p> <p>Departamenti i Bioteklogjisë plotëson të gjitha detyrimet ligjore të organizimit dhe strukturës akademike për zhvillimin e të gjitha niveleve të studimeve universitare dhe pasuniversitare të drejtuara prej saj si dhe të kryerjes së aktiviteteve kërkuese në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UT, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e njësive bazë.</p> <p>(Evidenca 1.20 shtesë marrë gjatë vizitës).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Rolin e koordinatorit të programit e luan Përgjegjësi i Departamentit i cili është autoriteti i më i lartë i Departamentit dhe monitoruesi i programeve të studimit që ofron Departamenti. Ndër të tjera, Përgjegjësi i Departamentit mbikqyr veprimtaritë mësimore dhe kërkimore / shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik, pas raportimeve në analizën vjetore të tij.</p> <p>Gjithashtu, koordinatori menaxhon angazhimin e stafit më të ri akademik të departamentit, stafit ndihmës akademik dhe ish studentët e diplomuar në realizimin e mësimdhënies, tezave të diplomës, dhe praktikave pranë institucioneve jashtë UT. Vëmëndje e veçantë i kushtohet mundësive për punësim të studentëve pranë këtyre kompanive në të ardhmen.</p> <p>Në mbarëvajtjen e Programit angazhohen edhe pedagogët kujdestarë për marrëdhëniet me studentin, një për çdo vit të programit të studimit, me misionin e përcjelljes së çdo problemi të studentëve tek autoritetet përkatëse, sipas kompetencës së tyre. Pedagogu kujdestar raporton ecurinë e Programit te Përgjegjësi/Koordinatori i Programit.</p> <p>(Evidenca 1.30; Evidenca 2.7; Evidenca 1.20 shtesë marrë gjatë vizitës).</p>


<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022, Departamenti i Bioteknologjisë përbëhej nga 10 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 4 Prof. As., 3 Dr., dhe 1 Msc., 16 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 9 Msc, si dhe 5 personel ndihmës akademik.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021, Departamenti i Bioteknologjisë përbëhej nga 10 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 4 Prof. As., dhe 4 Dr., 12 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 1 Prof. As., 3 Dr., dhe 6 Msc, si dhe 5 personel ndihmës akademik.</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, Departamenti i Bioteknologjisë përbëhej nga 10 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. Dr., 4 Prof. As., dhe 4 Dr., 11 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 3 Prof. Dr., 1 Prof. As., 1 Dr., dhe 6 Msc, si dhe 5 personel ndihmës akademik.</p> <p><i>(Evidenca 1.20; Evidenca 1.25; Evidenca 2.7; Evidenca 3.13; RVB, Anekse, Tabela 6.3; Evidenca 1.20 shtesë murrë gjatë vizitës).</i></p>						
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FSHN si njësia kryesore dhe Departamenti i Bioteknologjisë si njësia bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve. Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT në përputhje me rregulloren e UT dhe të Departamentit të Bioteknologjisë disponon dokumentacionin mbi organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.6-1.8; Evidenca 2.1; Evidenca 2.1.1).</i></p>

<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Bioteknologji” organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Struktura e planit përfshin disiplina të formimit të përgjithshëm dhe të disiplinave të fushës së studimit, të kategorizuara në lëndë bazë 17% (30 kredite), karakterizuese 53% (96 kredite), ndërdisiplinore 15% (27 kredite), plotësuese 10% (18 kredite), përmbyllëse 5% (9 kredite). Kjo shpërndarje e lëndëve në përqindje është në përputhje me përqindjet e lëndëve të përcaktuara nga VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar, e cila përcakton lëndë bazë (15-20%), karakterizuese (50-55%), ndërdisiplinore (12-15%), plotësuese (10-15%), përmbyllëse (3-5%).</p> <p><i>(Evidenca 2.1; Evidenca 1.8 e marrë gjatë vizitës).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai shtrihet në 3 vite studimi/6 semestra, me gjithsej 180 kredite, sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015, neni 73, pika 1.</p> <p><i>(Evidenca 2.1; Evidenca 2.1.1).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” përmban planin mësimor të detajuar në orë, kredite, kategori, mënyrën e vlerësimit të dijeve syllabuset e çdo discipline, listën e stafit akademik të brendshëm e të ftuar me ngarkesat përkatëse; të cilat përbëjnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi këtë program studimi.</p> <p>Planet mësimore të programeve të studimit japin një informacion të detajuar për ngarkesën mësimore, orët në auditor, ku 25 orë në auditor vlerësohet me një kredit. Informacion jepet gjithashtu mbi frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Për një vit akademik një student shpenzon 60 kredite, 1500 orë në vit dhe për të gjithë programin që përmban 180 kredite për të tre vitet shpenzon gjithsej 4500 orë.</p> <p>Ngarkesa mësimore totale e programit të studimit është 1991 orë në auditor dhe 2509 orë jashtë auditorit.</p> <p><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 1.25; Evidenca 2.1; Evidenca 2.1.1; Evidenca 2.4).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit. Pranimi i studentëve në programin e ciklit të parë kryhet në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, neni 74, Udhëzim i MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019.</p> <p>Në rregulloren e studimeve të Universitetit të Tiranës, rregulloren e programit të studimit Bioteknologji, kurrikulën dhe planin mësimor jepet informacion i qartë për studentët mbi kriteret e përgjithshme dhe</p>

	<p>specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Pranimi i studentëve në programin e ciklit të parë kryhet në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, nenit 74, Udhëzim i MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019.</p> <p>Kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve në programin e studimit përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. Kriteret specifike të pranimit propozohen nga Departamenti, miratohen nga Dekanati i FSHN dhe përcillen në rektoratin e UT. Kriteret e pranimit bëhen publike përmes publikimit të tyre në faqen zyrtare elektronike të UT dhe FSHN. UT-ja ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve në universitetin pritës janë 30 dhe pranohen kandidatët me rezultatet më të larta. Përveç notës mesatare studentit i transferohen kreditet e marra nga një program në tjetrin. Gjithashtu për transferimin e studentëve ngrihet komisioni i transferimit të studentëve nga Fakulteti.</p> <p>UT informon studentët përmes të rejave të publikuara në website www.fshn.edu.al.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.26; Evidenca 2.11.1-2.11.5).</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar.</p> <p><i>(Evidenca 1.9).</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Në programin Bachelor në “Bioteknologji” nuk ka ndryshime në ngarkesë, por janë rishikuar kategorizimet e disiplinave në përputhje me VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar, ndryshime të reflektuara në planin mësimor 2020-2021.</p> <p>Në këtë program studimi parashikohen përmirësime dhe përditësime të vazhdueshme, për lëndë të reja apo tema të reja brenda lëndës, në fillim të çdo viti akademik. Pasi miratohen në Departament dërgohen në Senat për miratim dhe më pas arkivohet dosja e plotë.</p> <p>Kërkesat për ndryshime vijnë nga Anëtarët e Departamentit dhe miratohen në Departament por këto ndryshime nuk kalojnë 20%.</p> <p>Këto ndryshime kanë konsistuar në këmbim lëndësh midis semestrave, zhvendosje të lëndëve në vite, ndryshim në ngarkesën mësimore si dhe futjen e lëndëve të reja.</p>





	<i>(Evidenca 1.8).</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Programi zhvillohet në 3 vite akademike me nga 60 kredite viti dhe një total prej 180 kreditesh për të gjithë programin e studimit; 1 kredit është 25 orë mësimore; Viti akademik përmban 1500 orë punë të studentit (orë në auditor dhe orë pune të pavarur). <i>(Evidenca 1.8; Evidenca 2.10).</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Përbajtja e veprimtarive si leksione të shoqëruara me praktika laboratorike dhe praktika profesionale, shpërndarja e lëndëve si bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese mundësojnë njohuri dhe aftësi për punësim të studentëve në fushën e Bioteknologjisë. Nga procedura e gjurmimit të studentëve pas diplomimit, procedurë e realizuar nga stafi i Departamentit të Bioteknologjisë, rezultojnë pjesa më e madhe e tyre vazhdojnë studimin në nivelin e dytë dhe të tretë të studimeve pranë të njëjtit departament, ose jashtë vendit dhe të tjerët janë të punësuar në institucione publike ose private të lidhura me profilin e Bachelor në “Bioteknologji” si: ndërmarrje farmaceutike, kompani për marketingun e pajisjeve laboratorike, laboratorë mjekësorë, industri ushqimore, etj. <i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.17).</i>
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësimin profesional.	Në programin e Bachelor në “Bioteknologji” disiplinat janë të organizuara në leksione, seminare dhe laboratore gjithë që ndikon në rezultatet e të nxënësve dhe aftësimin profesional të studentëve. Praktikën laboratorike ofrohen në laboratorët e mirëpajisur të Departamentit të Bioteknologjisë (laboratori i Bioteknologjisë Molekulare, laboratorit i Kulturave Indore dhe Fiziologjisë Bimore, laboratorit i Citologjisë – Citogjenetikës, laboratorit i Bioteknologjisë Ushqimore dhe Mikrobiologjisë, laboratorit i Akuakulturës, laboratorit i Mutagjenezës së Induktuar) ku studentëve u ofrohet mundësia të punojnë direkt në nivelin e makro- dhe mikroorganizmave (mikroorganizma ushqimorë, specie bimore e shtazore) e deri në manipulimin e biomolekulave (ARN, ADN, proteina, etj.). Shpërndarja në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite e orë mësimore, për çdo disiplinë të programit detajohet në syllabuse.

	<i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 2.1; Evidenca 2.1.1).</i>
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor. Organizimi i kurrikulës ka një shpërndarje të njëjtë të ngarkesës përgjatë semestrave, 30 kredite/semestër.</p> <p>Programi i studimit është hartuar, organizuar dhe rishikuar bazuar në programe të ngjashme ndërkombëtare dhe në sistemin European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS).</p> <p>Ngarkesa prej 60 ECTS për çdo vit akademik është e njëjtë ose e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Po kështu, struktura, përbërja në lëndë dhe shpërndarjen në kredite të grup-lëndëve është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, gjë e cila ka mundësuar shkëmbimet e stafit dhe studentëve me universitete ndërkombëtare.</p> <p><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 2.1).</i></p>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” mundëson një raport të përshtatshëm të formimit teorik dhe praktik të studentëve të verifikuar përmes mobiliteteve Erasmus të studentëve si dhe rezultateve të gjurmimit të shkollimit të mëtejshëm apo punësimit të tyre brenda ose jashtë vendit në fusha të lidhura me bioteknologjinë. Nga pyetësorët e plotësuar rezultoi se studentët që kanë përfunduar studimet e programit Bachelor në “Bioteknologji” vazhdojnë studimet në nivelin e dytë (94% e të diplomuarve). Nga këta, 70 % kanë ndjekur studimet Master Shkencor, 15% kanë ndjekur studimet Master Profesional, dhe vetëm 6% kanë ndjekur studimet e ciklit të tretë.</p> <p><i>(Evidenca 1.23; Evidenca 1.29; Evidenca 1.17; Evidenca 2.14).</i></p>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Përditësimi i programeve lëndore bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar përmirësim të planeve apo rishikim më të hollësishëm të syllabuseve dhe literaturës (tekste mësimore, materiale të tjera, mënyra e zhvillimit të mësimit – leksione, laboratore/seminare, praktika etj.). Këto ndryshime diskutohen në grupe mësimore dhe brenda stafit mësimor të Departamentit. Në syllabuset e lëndëve jepen literaturë bazë dhe ajo ndihmëse. Edhe gjatë vizitës në Bibliotekë konstatuam një literaturë të huaj të viteve të fundit plus teksteve mësimore të pedagogëve.</p> <p>Megjithëse ka një sasi të madhe të literaturës së vendit dhe të huaj, nevoja për literaturë bashkëkohore të 5 viteve të fundit është e nevojshme gjithmonë.</p> <p><i>(Evidenca 1.9; Vizita në Bibliotekë).</i></p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë të fushës së biologjisë. Programi siguron formimin e aftësive praktike në zbatimin e metodave të përshtatshme shkencore për interpretimin dhe</p>

parë.	<p>analizën e proceseve bioteknologjike si dhe të problemeve që lidhen me fushat e aplikimit të Bioteknologjisë.</p> <p><i>(Evidenca 2.10).</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hartuar me synim primar përgatitjen e bioteknologëve me njohuri në fushat Bioteknologji Mjekësore e Farmaceutike, Bioteknologji Bujqësore, Bioteknologji Ushqimore, Bioteknologji Mjedisore dhe fusha të lidhura me to. Në këtë kuptim, përshtatja me kërkesat e tregut të punës është shumë e favorshme. Kjo evidentohet dhe nga raporti i gjurmimit.</p> <p>Institucioni ka ngritur rrjetin ALUMNI, në mënyrë që të monitorojë në kohë reale punësimitin e studentëve që diplomohen duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta.</p> <p>Studentët që diplomohen në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” mund të vazhdojnë arsimimin e tyre të mëtejshëm në programet e ciklit të dytë të studimeve si Master Shkencor dhe Master Profesional.</p> <p><i>(Evidenca 1.16; Evidenca 1.16.1-1.16.3; Evidenca 1.17; Evidenca 2.15).</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në kërkim të vazhdueshëm për përmirësim të praktikave dhe punësimitit në të ardhmen të studentëve të diplomuar, stafi i Departamentit të Bioteknologjisë, organizon dhe merr pjesë në veprimtari me partnerë shkencorë dhe nga tregu i punës për t’u konsultuar.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka marrëveshje me kompani dhe Institucione të tjera në të cilat studentët kryejnë praktikat mesimore dhe gjithashtu shërbejnë për njohjen e studentëve për mundësitë e punësimit. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës organizon në mënyrë periodike Panairt e Karrierës për të ndihmuar studentët në një përfaqje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi. Në këto panairt marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat ofrojnë ndaj studentëve pozicionet e tyre vakante.</p> <p>UT realizon studim periodik të dinamikës së tregut të punës dhe problematika të tregut të punës për studentët që diplomohen në UT, por të përqëndruar kryesisht për nivelet e Ciklit të dytë, si nivel studimi që mundëson zhvillimin profesional në një llojshmëri më të gjerë profesionale e specialitetesh, në përputhje me kërkesat e tregut e punës në vendin tone.</p> <p>Politikat e punësimit në Shqipëri krijojnë mundësi shumë të kufizuara për punësim për studentët që kanë vetëm diplomë Bachelor në Bioteknologji. Këta studentë mund të punësohen me paga minimale, kryesisht në disa sektorë të administratës publike, asaj qendrore dhe lokale. Megjithatë, edhe për këto pozicione pune, studentët me diplomë Bachelor, konkurrohen nga ata me diplomë Master. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), ka në fokus orientimin në karrierë dhe këshillimin e vazhdueshëm të studentëve për drejtimin e duhur apo për të</p>

	ndërmarrë zgjedhje strategjike në karrierën e tyre. (Evidenca 1.30; Evidenca 1.31).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Për vitin akademik 2021-2022, në këtë program studimi janë angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 30 staf akademik efektiv (PAE), prej të cilëve: 8 Prof. Dr., 5 Prof. As., 14 Dr., dhe 3 Msc.; - 17 staf akademik me kontratë (PAK), prej të cilëve: 2 Prof. Dr., 3 Prof. As., 3 Dr., dhe 9 Msc. <p>Në aspektin numerik, për vitin akademik 21-22, raporti i stafit PAE/PAK është 63.8% / 36.2%.</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, në këtë program studimi janë angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 31 staf akademik efektiv (PAE), prej të cilëve: 8 Prof. Dr., 5 Prof. As., 13 Dr., dhe 5 Msc.; - 12 staf akademik me kontratë (PAK), prej të cilëve: 2 Prof. Dr., 4 Dr., dhe 6 Msc. <p>Në aspektin numerik, për vitin akademik 20-21, raporti i stafit PAE/PAK është 72.1% / 27.9%.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, në këtë program studimi janë angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 31 staf akademik efektiv (PAE), prej të cilëve: 8 Prof. Dr., 5 Prof. As., 13 Dr., dhe 5 Msc.; - 15 staf akademik me kontratë (PAK), prej të cilëve: 3 Prof. Dr., 4 Dr., dhe 8 Msc. <p>Në aspektin numerik, për vitin akademik 19-20, raporti i stafit PAE/PAK është 67.4% / 32.6%.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës mësimore që mbulohet nga stafi PAE dhe PAK në këtë program studimi, ajo paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 21-22, stafi PAE ka mbuluar 77.1% të ngarkesës mësimore në këtë program studimi, ndërsa stafi PAK ka mbuluar 22.9% të ngarkesës mësimore; - Në vitin akademik 20-21, stafi PAE ka mbuluar 80.5% të ngarkesës mësimore në këtë program studimi, ndërsa stafi PAK ka mbuluar 19.5% të ngarkesës mësimore;

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

	<p>– Në vitin akademik 19-20, stafi PAE ka mbuluar 81.7% të ngarkesës mësimore në këtë program studimi, ndërsa stafi PAK ka mbuluar 18.3% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar, ka një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe titullarët e lëndëve i kanë krijuar këto disiplina për herë të parë në këtë program, dhe vijojnë të jenë ekspertë të fushave përkatëse.</p> <p>Ngarkesa e stafit akademik është në përputhje me Vendimin Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, pika 2, b, ii, ku parashikohet që personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi, në këtë program studimi. Gjithashtu, titullaret e lëndëve kanë kualifikimin e duhur për dhënien e leksioneve si titullarë të tyre. Ata i përkasin kategorisë “Profesor”, ku përfshihen “Profesorë” dhe “Profesorë të Asociuar”.</p> <p><i>(Evidenca 1.20; Evidenca 1.25 shtesë gjatë vizitës; Evidenca 2.2; Evidenca 2.2.1; Evidenca 2.7; Evidenca 3.13; RVB, Aneksë shtesë gjatë vizitës, Tabelat 6 dhe 12).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.20; Evidenca 1.25; Evidenca 2.2; Evidenca 2.2.1; Evidenca 2.7).</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p><i>(Evidenca 1.25; Evidenca 2.2; Evidenca 2.2.1).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UT dhe FSHN ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike e private (Akademia e Shkencave, UBT, QTTB, ISUV, ISHP, etj. Synimi kryesor i tyre ka qenë realizimi i praktikave laboratorike të disiplinave të bioteknologjive industriale, udhëheqja e studentëve në praktika laboratorike dhe veprimtari të tjera specifike (pjesëmarrje në projekte kombëtare, konferenca të organizuara në bashkëpunim, etj.).</p> <p><i>(Evidenca 1.23; Evidenca 1.30; Evidenca 1.31).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera</p>	<p>Departamenti i Bioteknologjisë ka të angazhuar në mësimdhënie pranë Bachelor në “Bioteknologji” 5 anëtarë të stafit ndihmës akademik të gjithë të diplomuar pranë programeve të FSHN, UT, 3 prej tyre pranë Departamentit të Bioteknologjisë. Të gjithë janë të diplomuar në ciklin e</p>

mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	II të studimeve Master i Shkencave.		
	Stafi ndihmës akademik është përgjegjës për realizimin e orëve laboratorike, asistencën e studentëve gjatë përgatitjes së tezave të diplomës, dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike.		
	<i>(Evidenca 2.7; Evidenca 2.16).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>Mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” bëhet sipas standardeve të vendosura nga UT, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Institucioni ka hartuar dhe përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihen edhe informacion mbi metodat e mësimdhënies në varësi të specifikave të programit të studimit dhe të lëndëve që ofrohen në të.</p> <p>Në strategjinë e Universitetit të Tiranës përcaktohen qartë udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p> <p>Në FSHN organizohen mjaft leksione të hapura ku pedagogë dhe studentë njihen me të rejat e shkencës dhe të mësimdhënies gjithashtu.</p> <p><i>(Evidenca 1.2; Evidenca 6.2).</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, me anë të pyetësorëve që i bëjnë studentëve si dhe vlerësimit që bëhet nga vetë pedagogët për vlerësimin e lëndës.</p> <p>Rektorati UT ka miratuar planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Procesi i monitorimit të cilësisë në UT funksionon bazuar në një rregullore që përcakton mënyrën e organizimit të proceseve të kontrollit</p>


	<p>ose monitorimit të mësimdhënies, mbështetjes dhe matjes së efikasitetit të tyre si dhe disponon Paketën e sigurimit të cilësisë dhe manualin e sigurimit të cilësisë mbi bazën e të cilit funksionon.</p> <p>Struktura përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në FSHN, UT është DSBC (Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) e cila vepron bazuar në një rregullore të posaçme. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierrës (DSBCK) organizon pyetësorë drejtuar studentëve për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët. Rezultatet përpunohen nga DSBCK dhe i dërgohen për analizë departamenteve të fakultetit. Departamenti organizon në mënyrë periodike diskutime dhe kontrole në lidhje me aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik. Në nivel FSHN, UT janë realizuar formularë vlerësimi nga studentët.</p> <p>Veç kësaj, edhe në nivel departamenti janë realizuar mekanizma të monitorimit dhe të vlerësimit nga stafi akademik dhe ndihmës akademik. Vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative është gjithashtu i adresuar me vëmendje nga personeli akademik, mbi bazën e të cilave janë hartuar raporte vjetore të cilat përdoren nga autoritetet drejtuese për të adresuar problematika.</p> <p><i>(Evidenca 1.13; Evidenca 1.15; Evidenca 3.4; Evidenca 3.5; Evidenca 3.7; Evidenca 3.9; Evidenca 3.10; Evidenca 6.1; Evidenca 6.2).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët e FSHN, specifikisht ata të programit Bachelor në “Bioteknologji” janë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies me anë të pyetësorëve në nivel FSHN dhe tutoriatit në nivel departamenti.</p> <p>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT, për procesin e vlerësimit periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, institucioni siguron përfshirjen e studentëve në këto vlerësime periodike. Studentët japin vlerësimin e tyre në formë anonime dhe nëpërmjet fokus grupeve.</p> <p>Komponentët kryesorë të pyetësorit për të cilat studentët duhet të shprehen janë: rreth pedagogut; programit të studimit në përgjithësi; nëse kurrikula siguron lidhje të praktikës me teorinë; për infrastrukturën që ofron departamenti, etj.</p> <p>Nga pyetësori arrihet të përfitohet mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi lëndët në veçanti, mbi pedagogët që mobilizohen në auditor, mbi syllabusin, literaturën, vlerësimin e dijeve, etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 2.17; Evidenca 3.4-3.8).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët pasi përpunohen nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierrës (DSBCK), i komunikohen autoriteteve drejtuese të FSHN, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Drejtuesi i Departamentit. Departamenti analizon</p>




	<p>rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.</p> <p><i>(Evidenca 1.13; Evidenca 1.15; Evidenca 3.4; Evidenca 3.5; Evidenca 3.7; Evidenca 6.1; Evidenca 6.2).</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Pasi Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierrës (DSBCK) organizon pyetësorët drejtuar studentëve për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët, rezultatet përpunohen nga DSBCK dhe i dërgohen për analizë departamentit të fakultetit. Departamenti organizon në mënyrë periodike diskutime dhe kontrole në lidhje me aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik. Departamenti organizon në mënyrë periodike diskutime dhe kontrole në lidhje me aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik duke promovuar eksperiencat më të mira.</p> <p><i>(Evidenca 1.13; Evidenca 1.15; Evidenca 1.27; Evidenca 3.4; Evidenca 6.1; Evidenca 6.2).</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Syllabuset e Programit të Studimit, për secilën nga lëndët që ofrohet ekziston një syllabus që pasqyron mësimdhënien dhe mësimnxënien: leksione, seminare, praktika mësimore, laboratorë, detyra, projekte, literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Programet e studimit hartohen nga çdo pedagog dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Bazuar në specifikën e çdo lënde të kurrikulës së programit Bachelor në “Bioteknologji” janë hartuar dhe miratuar syllabuset sipas modelit të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Gjithashtu Departamenti i Bioteknologjisë organizon vazhdimisht leksione të hapura, workshope dhe aktivitete të ndryshme me pedagogë të ftuar të huaj dhe vendas.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.6; Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 2.13.1).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies përveç atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte lëndore në grupe, mjete audio-vizive, etj. Aplikohen gjithashtu metoda të reja të mësimdhënies, si përgatitja e leksioneve në formatin “Poëer Point” dhe paraqitja me mënyra audiovizive me video projektor. Departamenti i Bioteknologjisë në përputhje me specifikat e programit Bachelor në “Bioteknologji”, u ka ofruar studentëve metoda të e-learning në disa platforma (Google meet, Microsoft Teams, Zoom, etj.), paraqitje elektronike të leksioneve, linqeve,</p>

	<p>ëbsiteve, testeve, ëorkshopeve e konferencave, leksioneve të hapura, forumeve etj.</p> <p>Mësimdhënia dhe transmetimi i dijeve përfshin mënyra apo forma të ndryshme si leksione, seminare, punë laboratorike (detyra kursi, ushtrime etj). Programi i lëndëve/syllabuset përfshin elementët e mësimdhënies, detyrimet e studentit dhe literaturën. Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me modelin e dhënë të VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar.</p> <p><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 3.1-3.3).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Universiteti i Tiranës mbështet personelin akademik në aspektin didaktik dhe teknologjik që lehtëson procesin mësimor. Konkretisht, në fillim të çdo viti akademik, departamentet paraqesin projekt buxhetin me kërkesat e stafit akademik të cilat kanë të bëjnë me elementë të bazës laboratorike për mësimdhënie, punëve laboratorike, praktikave në terren, paisje kompjuterike, projektorë, etj.</p> <p>Personeli akademik ka mundësi të përfitojë edhe nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohuri me praktikatat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Për këtë qëllim institucioni stimulon pedagogët të përfshihen në projekte të ndryshme për shkëmbim eksperience në funksion të rritjes së nivelit didaktik dhe akademik të stafit pedagogjik. Numri i pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare në nivel Departamenti është 22.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik është miratuar ngritja e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Univesitetin e Tiranës, e cila mundëson zhvillimin e metodave të ndryshme pedagogjike të mësimdhënies.</p> <p>FSHN, UT, në mbështetje të përmirësimit të kompetencave didaktike të personelit akademik, ofron wifi në të gjitha godinat dhe pajisje elektronike të përshtatshme. Përdorimi i platformave online për mësimdhënie dhe e-learning, është standardizuar (platformat Google meet dhe Microsoft Teams) duke bërë që të rritet shumëllojshmëria e prezantimit pedagogjik dhe rezultatet e të nxënit në përputhje me programin mësimor</p> <p>Në tre vitet e fundit akademike, në funksion të sa më sipër, në Departamentin e Bioteknologjisë, FSHN, UT, janë gërshetuar mësimdhënia në auditor me atë online për të mundësuar aftësimin praktik laboratorik të studentëve që është shumë specifik për programin Bachelor në “Bioteknologji”, me atë online.</p> <p><i>(Evidenca 1.24, Tab.19; Evidenca 3.1-3.3; Evidenca 3.12; Evidenca 4.14).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të</p>

<p>e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit dhe CV e stafit akademik të këtij programi e vërtetojnë këtë. Çdo anëtar i personelit akademik përdor paraqitje elektronike të leksioneve, linqeve, websiteve, videove, testeve, workshopeve e konferencave, leksioneve të hapura, forumeve, etj.</p> <p>Programi Bachelor në “Bioteknologji” është i hartuar bazuar në tre komponentë mësimdhënieje (leksione, seminare dhe laboratore) ku praktikat laboratorike kanë një rëndësi të posaçme. Për këtë qëllim, në këto tre vite akademike, që përkuan dhe me pandeminë COVID-19, për të plotësuar sa më mirë njohuritë dhe konceptet specifike sipas disiplinave, personeli u angazhua në hartimin e një plan-programi që kombinonte praktikat laboratorike në auditor në grupe të vogla studentësh me ato online, me grupe të vogla studentësh në përputhje me masat anticovid.</p> <p><i>(Evidenca 1.25; Evidenca 2.2; Evidenca 2.2.1; Evidenca 2.7; Evidenca 3.13; Evidenca 3.14).</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e Bioteknologjisë bën vlerësimin e lëndës apo moduleve që japin me anë të pyetësorëve nga studentët, dhe në këtë mënyrë ato reflektojnë sugjerimet e tyre. Gjithashtu nga DSBCK zhvillohen pyetësorë për pedagogët dhe zhvillimin e mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 2.17; Evidenca 3.4-3.8).</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentë të programit të studimit të Bioteknologjisë treguan një komunikim mjaft të mirë me pedagogët e këtij programi. Konkretisht kjo realizohet nëpërmjet diskutimeve interaktive mes pedagogëve dhe studentëve, sidomos gjatë seancave praktike mësimore dhe punëve laboratorike, ku grupet me numër të vogël studentësh e lehtësojnë komunikimin. Sallat e laboratoreve janë të pajisura me infrastrukturë të kënaqshme si mikroskopë me monitorë dhe kamera, kompjutera të lidhur me internetin ku mund të demostrohen procese të caktuara të punëve laboratorike që e lehtësojnë procesin e të kuptuarit të studentët për të zhvilluar më pas punën praktike.</p> <p>Studentët hartojnë dhe prezantojnë detyra kursi gjatë gjithë kohëzgjatjes së disiplinave, gjë që ofron mundësinë për komente, diskutime dhe rritjen e nivelit të atraktivitetit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Përdorimi i pajisjeve vizuale, shembujt konkret nga praktika vendase apo e huaj është me interes për studentët dhe reflektohet tek përditësimi i syllabuseve të programit dhe përgjigjet e pyetësorëve të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 1.9; Takimi me studentët e programit).</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies nga pedagogët e programit të studimit bachelor në “Bioteknologji” inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Realizimi i detyrave të kursit dhe prezantimi i tyre nga studentët online ose në auditor, është një praktikë e përcaktuar në syllabuset e të gjithë disiplinave të Bachelor në “Bioteknologji”. Kjo ka sjellë aftësimin e studentëve në prezantim dhe interpretimin shkencor të të dhënave, shtimin e vetësigurisë së tyre dhe ndërtimin e marrëdhënies profesionale</p>





	ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Të gjitha format e mësimdhënies të mbështetura nga mënyra e komunitit pedagog-student, ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. (Evidenca 1.4; Evidenca 3.31).								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Në dispozicion të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” janë 4 godina me auditore për leksione, seminare dhe laboratore: Totali i ndërtesës “A” ka 10 salla mësimi me një kapacitet total 588 vende dhe sipërfaqe 502.62 m²; Totali i ndërtesës “B” ka 4 salla mësimi me një kapacitet total 328 poste dhe sipërfaqe 288.6 m²; Totali i posteve për godinën “C” është 486 poste pune për studentët dhe sipërfaqe 496.68 m²; Totali i ndërtesës “D” ka 6 salla mësimi me një kapacitet total 694 poste studenti dhe sipërfaqe 1107.3 m². Sipërfaqja për student në FSHN, UT, rezulton të jetë 5.3 m², pra është brenda standardit të vendosur nga VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 që është 1 student/5 m.</p> <p>Laboratorët e disiplinave të programit Bachelor në “Bioteknologji”, realizohen në mjediset e departamenteve të kimisë, kimisë industriale, fizikës, biologjisë, dhe për lëndët karakterizuese në laboratorët e Departamentit të Bioteknologjisë (God. C, Kati I: Laboratori i bioteknologjisë molekulare, laboratori i Fiziologjisë Bimore dhe Kulturave in vitro, laboratori i Mikrobiologjisë dhe Bioteknologjisë Ushqimore, laboratori i Mutagjenezës së Induktuar, laboratori i Citologjisë dhe Citogjenetikës, laboratori i Akuakulturës). Të gjitha mjediset mirëmbahen rregullisht. Një pjesë e praktikave laboratorike realizohen pranë QKFF, FSHN, dhe praktika eksperimentale pranë serës në QFBZ, UT.</p> <p><i>(Evidenca 1.11.1; Evidenca 1.18; Evidenca 3.17; Vizita në ambientet e Institucionit).</i></p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Programi Bachelor në “Bioteknologji” realizohet në mjediset e FSHN, UT, respektivisht leksionet dhe seminarët në auditore të katër godinave (A, B, C, D) të mirëpajisura me projektorë e kompjutera, sistem ngrohjeje-ftohjeje, ndriçim të përtshatshëm. Praktikën laboratorike kryhen në laboratorët e Kimisë, Kimisë Industriale, Fizikës, Biologjisë, dhe për

	<p>lëndët karakterizuese në laboratorët e Departamentit të Bioteknologjisë, të cilat janë të pajisura me pajisje laboratorike funksionale në shërbim të realizimit të programit të disiplinave përkatëse. Mjetet audio-vizuale janë të instaluar në mënyrë permanente në auditoret e Godinave B dhe D. Për Godinat A dhe C stafi akademik zotëron laptop-ë dhe videoprojektorë portabël për pasurimin e metodologjisë së mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidenca 1.21; Evidenca 3.19; Vizita në ambjentet e Institucionit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, hapësirat për kryerjen e procesit mësimor dhe shkencor të programit të “Bioteknologjisë” mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si kompjutera videoprojektor, ekrane projektimi, flipchart, tabela interaktive, etj. Kjo mundëson realizimin e mësimdhënies me metoda e teknologji bashkëkohore dhe në përputhje me specifikat e lëndëve.</p> <p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në Bachelor në “Bioteknologji”, që i përket 7 njësive bazë të FSHN, UT, disponon poste pune të mirëpajisura me kompjutera, laptopë, projektorë dhe wifi. Njëherazi, stafi dhe studentët kanë në dispozicion bibliotekën e FSHN, UT, që posedon 140 poste, përveç bibliotekës, studentët kanë akses dhe në kompjuterat e laboratorëve të lidhur me pajisje e softje specifike për përpunimin e të dhënave që do të përdoren për përpilimin e raporteve laboratorike. Në dispozicion të studentëve është dhe laborator i Biostatistikës pranë Departamentit të Biologjisë, FSHN, UT që disponon 20 poste të pajisur me kompjutera për këtë qëllim.</p> <p><i>(Evidenca 1.18; Evidenca 3.17; Evidenca 3.18; Vizita në ambjentet e Institucionit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në syllabusin e secilës lëndë të zhvilluar në programin Bachelor në “Bioteknologji” është përshkruar literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura bazë e lëndës është në gjuhën shqipe, në formën e leksioneve të shkruara, ndërsa në literaturën ndihmëse listohen edhe tituj bashkëkohor në gjuhë të huaj. Programi Bachelor në “Bioteknologji” vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse përkatësisht në gjuhët shqipe dhe angleze për çdo disiplinë. Në mënyrë të detajuar, këto përshkruhen në syllabuset e disiplinave të programit. Pjesë e literaturës ndihmëse janë leksionet e dërguara elektronikisht përmes platformave online. Kjo literaturë garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.9; Evidenca 3.17-3.20).</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në</p>	<p>Nga vizita në Bibliotekën e FSHN u pa një numër i madh literature në gjuhën shqipe të botuar nga pedagogë të këtij fakulteti dhe të vënë në</p>

<p>drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>dispozicion për studentët e programit të Bioteknologjisë, gjithashtu një numër i madh i librave në gjuhë të huaj dhe një literaturë e kohëve të fundit. Literatura bazë e syllabuseve është e depozituar në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Kjo bibliotekë me sipërfaqe rreth 561.1 m² gjendet në katin e parë të ndërtesës B dhe është ndër më të mëdhatë dhe të rëndësishmet në Universitetin e Tiranës. Biblioteka ofron shërbim me dy turne, në tre mjedise studimi e shërbimi, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë edhe nga studentët e programit. Kjo bibliotekë funksionon bazuar në një rregullore të brendshme. Biblioteka e FSHN, UT, ka në përbërje të saj 140 poste studentësh dhe organizohet në një organikë të përbërë nga 4 persona në shërbim të stafit dhe të studentëve. Biblioteka disponon 80.018 libra, 36.60 njësi, nga të cilët, 1.158 shqip dhe 35.443 gjuhë e huaj. Titujt e librave janë të përditësuar, bashkëkohorë duke i informuar studentët me të dhënat e fundit të shkencës.</p> <p><i>(Evidenca 1.27; Evidenca 3.16-3.20; Vizita në ambientet e Institucionit).</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>FSHN është e regjistruar në 3 burime “online” të Konsorciumit Ndërkombëtar EIFL.</p> <p>https://www.elgaronline.com/broëse?access=user&level=parent https://iopscience.iop.org/journalList https://msp.org/publications/journals/</p> <p>Në funksion të mësimdhënies personeli akademik mund të përdorë edhe faqen https://ulibrary.rash.al/ e cila funksionon me regjistrime paraprake dhe adresa email-i.</p> <p>Biblioteka e FSHN, UT, me tituj shqip dhe në gjuhë të huaj është në dispozicion të programit Bachelor në “Bioteknologji”. Një pjesë e titujve janë dixhitalizuar, dhe konkretisht 1520 regjistrime në Library for Windows 98, 1879 regjistrime në sistemin COBISS. Veç kësaj biblioteka ofron shërbime online për 4 burime: EDGAR, IOP, ATSM dhe MSP.</p> <p><i>(Evidenca 3.18).</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në vizitën që u zhvillua në Institucion u pa një numër i madh laboratorësh me pajisje laboratorike në funksion të mësimit dhe kërkimit shkencor. Programi Bachelor në “Bioteknologji” mbështetet në infrastrukturën laboratorike të 5 departamenteve të FSHN, UT (laboratorët e Kimisë, Kimisë industriale, Fizikës, Biologjisë dhe të Bioteknologjisë). Infrastruktura e tyre është pasuruar në vazhdimësi dhe plotëson nevojat për një kërkim bazë dhe të avancuar në drejtimet e bioteknologjisë. Në mënyrë të detajuar, realizimi i praktikave specifike laboratorike për çdo disiplinë përshkruhet në syllabuset e lëndëve ku pasqyrohen mjediset, lektorët dhe mjediset me infrastrukturën përkatëse për tematikën.</p> <p><i>(Evidenca 1.9; Evidenca 1.18; Evidenca 1.21; Vizita në ambientet e Institucionit).</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik</p>	<p>Gjatë periudhës dy vjeçare të pandemisë Covid 19, mësimi në FSHN është</p>

<p>përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>realizuar “online” nëpërmjet platformës Teams. Stafit i IT i UT ka garantuar aksesin në këtë platformë të personelit akademik dhe studentëve, duke mundësuar kështu e-learning. Secili pedagog ka krijuar klasat virtuale për zhvillimin e leksionit, seminarit dhe laboratoreve për ato lëndë që mund ta zhvillojnë laboratorin online. Departamenti i Bioteknologjisë në përputhje me specifikat e programit Bachelor në “Bioteknologji”, u ka ofruar studentëve metoda të e-learning në disa platforma (Google Meet, Microsoft Teams, Zoom, etj.), paraqitje elektronike të leksioneve, linqeve, ëbsiteve, testeve, ëorkshopeve e konferencave, leksioneve të hapura, forumeve etj. Kjo praktikë e iniciuar në kushtet e imponuara nga pandemia, do të vijojë të përdoret në situata specifike (workshope, konferenca ndërkombëtare, leksione të hapura) për të siguruar pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në aktivitete të tilla me rëndësi.</p> <p><i>(Evidenca 3.3; Evidenca 3.4).</i></p>		
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personelit akademik, dhe studentëve, përveç platformës dixhitale Microsoft Teams, u mundësohet nga UT/FSHN edhe adresa zyrtare e email-it me anë të së cilës aksesojnë dhe platformën Teams. Adresat zyrtare elektronike ofrohen në nivel fakulteti dhe nivel universiteti. Adresa e stafit akademik dhe ndihmës-akademik është: emer.mbiemer@fshn.edu.al dhe emer.mbiemer@unitir.edu.al, kurse për studentët është: emer.mbiemer@fshnstudent.info dhe emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al. Aksesimi i këtyre adresave bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të UT/FSHN e cila funksionon në dy gjuhë, në anglisht dhe në shqip. Kjo faqe përmban informacione të përgjithshme mbi fakultetin, historikun e tij, departamentet, stafin, organigramën, etj. Në rubrikën “student” studentët mund të marrin informacion në lidhje me jetën studentore, oraret e kurseve, pedagogët, leksionet, material mësimore, administratën, etj.</p> <p><i>(Evidenca 3.3).</i></p>		
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Sipas Rregullores së UT, rregullores së Departamentit të Bioteknologjisë dhe të programit Bachelor në “Bioteknologji” diplomimi realizohet me provim përfundimtar. Studentët pajisen me një program të detajuar dedikuar provimit final i cili hartohet nga stafi akademik i angazhuar në Bachelor në “Bioteknologji”. Në mënyrë periodike, stafi akademik angazhohet në sqarimin e studentëve gjatë gjithë semestrit të dytë të vitit III. Hartimi i programit të provimit të formimit bëhet nga një komision <i>ad-hoc</i> i ngritur nga DB dhe i miratuar nga Dekanati.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.6; Evidenca 1.7; Evidenca 3.21).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka ngritur Komisionin e Përherëshëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë (KPSSC) si një strukturë në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo strukturë ka për funksion kryesor sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, që përfaqëson një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore. DSBCK zbaton “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur njëkohësisht në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”. Me vendim të Senatit Akademik është miratuar Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik.</p> <p><i>(Evidenca 1.13; Evidenca 1.15; Evidenca 3.22; Evidenca 3.22.1).</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Në shërbim të rritjes së cilësisë dhe vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit, Departamenti i Bioteknologjisë ka mbështetur kualifikimin e vazhdueshëm të stafit trainimet periodike dhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta me institucione brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunimi me staf akademik të ftuar brenda dhe jashtë vendit është një vlerë e shtuar për cilësinë e mësimdhënies në këtë program.</p> <p>DBT është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e Bioteknologjisë. Departamenti përzgjedh personel akademik të kualifikuar mbi bazën e konkurseve të hapura dhe e nxit atë të specializohet dhe trajnohet në fushën përkatëse të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Departamenti harton një raport vjetor të aktivitetit mësimor-kërkimor ku përshkruhet përmbledhurazi procesi mësimor për secilën lëndë të zhvilluar në programin Bachelor në “Bioteknologji” dhe aktiviteti kërkimor i secilit anëtarë të personelit akademik. Të dhënat e këtij raporti diskutohen në mbledhjet e departamentit duke vlerësuar arritjet dhe jepen mendime për boshllëqet e vërejtura.</p> <p>Rezultatet e pyetësorit që DSBCK zhvillon me studentët për lëndë të ndryshme të programit Bachelor në “Bioteknologji” janë të dhëna të mira orientuese për mendimin që kanë studentet rreth cilësisë së mësimdhënies. Këto rezultate diskutohen në mbledhjet e departamentit me qëllim plotësimin e boshllëqeve dhe rritjen e cilësisë në të ardhmen.</p> <p><i>(Evidenca 1.22; Evidenca 1.24; Evidenca 1.31; Evidenca 2.13).</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin</p>	<p>Në funksion të cilësisë të programit të studimit është miratuar ngritja e</p>




<p>eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës. Ngritja e qendrës virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit në Univesitetin e Tiranës, e cila ndikon në zhvillimin profesional dhe njohjen me metoda te reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Strukturat e FSHN, UT kanë nxitur e mbështetur zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies online përmes ofrimit të trajnimeve dhe asistencës për përdorimin e platformave Google Meet dhe Microsoft Teams, Zoom.</p> <p>Në FSHN sallat e leksionit janë të pajisura me projektor të lidhur me kompjuter. Laboratorët gjithashtu janë të pajisur me mikroskopë cilësorë ku të paktën njëri prej tyre është i lidhur me një kamera që e paraqet imazhin në monitor LED.</p> <p><i>(Evidenca 3.1-3.3; Evidenca 3.12).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>CV e stafit tregojnë që stafi i angazhuar në programin Bachelor në “Bioteknologji” është i kualifikuar dhe trajnohet në mënyrë të vazhdueshme në shërbim të një mësimdhënieje cilësore. Kjo evidentohet me raportet vjetore të Departamentit të Bioteknologjisë, CV-të për aktivitetin në 5 vitet e fundit, një tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit dhe tabelën përmbledhëse që pasqyron nivelin e kualifikimit të stafit sipas grupmoshës.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Bioteknologjisë është vazhdimisht i angazhuar në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare duke rritur nivelin e tyre të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor personeli akademik është i angazhuar me kohë të pjeshme jashtë UT. UT dhe FSHN mbështet kualifikimin e stafit akademik në pjesëmarrjen e tij në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. Aktivitet shkencore si konferenca, workshope, ekspedita studimore në terren të planifikuara, bëhen pjesë e projekt-buxhetit të departamentit në fillim të çdo viti akademik. Shpesh në projekte apo angazhime të tjera të stafit akademik përfshihet edhe personeli ndihmës dhe studentë të cilët ndihmojnë në zhvillimin e punës duke fituar përvojë për të punuar në mënyrë të pavarur në të ardhmen.</p> <p><i>(Evidenca 1.24; Evidenca 1.32; Evidenca 2.2; Evidenca 3.23).</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin Bachelor në “Bioteknologji” është i trajnuar për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse në auditor dhe online, gjatë bashkëpunimeve, workshopeve e projekteve. Për këtë kanë shërbyer pjesëmarrja në projektin Erasmus+ gjatë të cilave stafi akademik ka shkëmbyer eksperiencën mësimdhënieje në universitete të mirënjohura europiane dhe/ose është trainuar për teknika laboratorike specifike. Përveç kësaj, strukturat e FSHN, UT, kanë nxitur e mbështetur zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies online përmes ofrimit të trainimeve dhe asistencës për përdorimin e platformave Google Meet dhe Microsoft</p>



	<p>Teams, Zoom.</p> <p>Trajnimet e personelit akademik në Departamentit të Bioteknologjisë për përmirësimin e aftësive të mësimit janë të vazhdueshme. Ato realizohen kryesisht nga marrëveshje të ndryshme që UT ka realizuar në kuadër të programeve si Erasmus, Erasmus+, Erasmus KA107, CEEPUS etj. Për mbarëvajtjen dhe lehtësimin e procedurave të aplikimit të stafit dhe studentëve, FSHN i ka dedikuar këtij programi edhe një koordinator i cili njëkohësisht është Zv/Dekan për kurikulat.</p> <p>Në kuadër të programit Erasmus+ që mbështetet nga Bashkimi Evropian janë krijuar mundësi të shumta studimi, mësimit dhe trajnimi jashtë vendit për stafin akademik, ndihmës akademik dhe studentë. Nga këto bursa kanë përfutur edhe disa pedagogë të Departamentit të Bioteknologjisë si dhe studentë të programit Bachelor që kanë zhvilluar një semestër të programit të tyre të studimit në universitete të ndryshme të Evropës.</p> <p><i>(Evidenca 1.22; Evidenca 1.27; Evidenca 1.32; Evidenca 3.1; Evidenca 3.3).</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimit dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik i programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” është përgjegjës për zbatimin dhe cilësinë e mësimit në përputhje me statutin dhe rregulloren e UT dhe në zbatim të programit të studimit. Personeli akademik është i trajnuar për mësimit dhe kërkim shkencor në vazhdimësi në kuadër të mobiliteteve dhe në kuadër të projekteve të tjera shkencore multilaterale, bilaterale dhe kombëtare.</p> <p>Stafi ndihmës akademik i Departamentit të Bioteknologjisë është përzgjedhur kryesisht nga studentë të diplomuar në këtë program me synimin që të kenë kompetencat e nevojshme për realizimin e praktikave eksperimentale. Gjithashtu stafi ndihmës akademik merr pjesë aktive në projektet kërkimore shkencore dhe realizimin e temave eksperimentale të Departamentit të Bioteknologjisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidenca 1.7; Evidenca 1.24; Evidenca 2.2.2).</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimit, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik aplikon metoda bashkëkohore në mësimit duke përdorur teknologjinë e informacionit. Konkretisht për dy vite akademike (2019-2020, 2020-2021) është përdorur dhe testuar për herë të parë zhvillimi i mësimit “online” si metoda inovative e mësimit.</p> <p>Me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimit, në përfundim të lëndës, çdo anëtar i personelit akademik u paraqet studentëve një pyetësor mbi mënyrën se si është konceptuar programi i lëndës, metodologjia, cilësia e mësimit, metodat e kontrollit të dijes të aplikuara, etj. Rezultatet e marra përdoren nga stafi për të përditësuar syllabuset e disiplinave dhe për</p>



	<p>të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie. Pajisja e sallave të leksioneve me projektor i mundëson pedagogut zhvillimin e mësimin në mënyrë tërheqëse duke paraqitur leksionin në ppt., shoqëruar edhe nga video demonstruese që e lehtësojnë procesin e të kuptuarit.</p> <p>Gjatë pandemisë Covid19 personeli akademik aplikoi metoda bashkëkohore në mësimdhënie duke zhvilluar mësimin plotësisht online nëpërmjet platformës Teams. Laboratorët e disa lëndëve të Programit, në bashkëpunim me stafin ndihmës akademik u regjistruan si video dhe u ngarkuan në klasën përkatëse virtuale të platformës Teams. Këto seanca laboratorike gjenden gjithashtu në Youtube në mënyrë që të gjithë studentet e interesuar mund ti ndjekin edhe në të ardhmen.</p> <p><i>(Evidencat 3.1-3.4; Evidenca 3.7; Evidenca 3.9).</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret, mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve përcaktohen në rregullore të veçanta, si në rregulloren e UT, Rregulloren e departamentit dhe në Rregulloren e programit të Bioteknologjisë.</p> <p>Detajet mbi kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve për të gjitha disiplinat e programit të studimit, paraqiten dhe në syllabuset e lëndëve gjithashtu janë publike në website-n e FSHN, ndërfaqja e Departamentit të Bioteknologjisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidenca 1.6; Evidenca 1.9; Evidenca 3.24).</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Pedagogu i lëndës i prezanton studentëve syllabusin dhe i informon ata mbi: emërtimin dhe kreditet e lëndës, pedagogun ose pedagogët e lëndës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve si dhe literatura e detyruar dhe ajo</p>




	e rekomanduar. <i>(Evidenca 1.9).</i>								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mënyrat për testimin e dijeve të studentëve të aplikuar në programin Bachelor në “Bioteknologji” janë të përshkruara në syllabuset e disiplinave nën emërtesën “Kontrolle të ndërmjetme; Detyra kursi: Laboratore; Provimi final”. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Përgjithësisht procesi i vlerësimit është kompleks dhe përbëhet nga disa komponentë si testime me shkrim dhe me gojë, detyra kursi, prezantime, mbrojtje të praktikave profesionale etj. Vlerësimi përfundimtar bazohet në përqindjen që ka çdo komponent i përcaktuar paraprakisht në syllabus në lidhje me kontrollin e dijeve. <i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.9; Evidenca 3.24).</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Në programin Bachelor në “Bioteknologji”, testimi dhe vlerësimi i njohurive bazohet në rregulloren e UT në rregulloren e programit. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhduar në të gjitha lëndët, por ky vlerësim është më i konsoliduar në disa lëndë të cilat janë me vlerësim të vazhduar (VLV). Në programin e studimit ka disa lëndë VLV ku vlerësimi përfundimtar nuk mbështetet në një provim final, por vetëm në pikët e akumuluar nga studenti gjatë lëndës, të parashikuar në syllabus. Në lëndët VLV studenti testohet disa herë gjatë semestrit. he përshkruhet në detaje sipas disiplinave në syllabuset përkatëse. Përcaktimi i raporteve ndërmjet mënyrave të vlerësimit, bëhet nga pedagogët dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik në nivel departamenti. <i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.6; Evidenca 1.7; Evidenca 1.9; Evidenca 3.24).</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<i>Institucioni aktualisht nuk ka një sistem elektronik vlerësimi, por gjatë vizitës në Institucion u konfirmua që po bëhet gati për vitin e ri akademik 2022-2023. Gjatë periudhës së pandemisë Covid19, Platforma Teams e vënë në dispozicion nga Universiteti i Tiranës për zhvillimin e mësimit në distancë është shfrytëzuar edhe për kryerjen e provimeve. Kjo mënyrë testimi ka garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm të vlerësimit të studentëve. Rezultatet e provimeve dhe</i>

	<p>komentet përkatëse ju përcillen studentëve automatikisht në mënyrë individuale, çka rrit transparencën, shmang vonesat, ruan konfidencialitetin dhe ndihmon mbarëvajtjen e menaxhimit të të dhënave nga institucioni.</p> <p><i>(Evidenca 3.2; Evidenca 3.3; Takimi me stafin dhe studentët).</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit mund të bëhet me provim me shkrim ose gojë, sipas përcaktimit që është bërë në syllabus. Komisioni i vlerësimit përbëhet gjithmonë të paktën nga dy anëtarë, titullari i lëndës dhe asistenti tij. Në rastet kur nuk ka asistent, anëtari i dytë përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili përgjigjet dhe ndjek zhvillimin e provimit. Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentit. Kur lënda ka asistent vlerësimi bëhet nga të dy pedagogët që angazhohen në lëndë. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës sipas formatit të miratuar në departament dhe çdo vit riformulohet. Në rastet kur lënda ka një asistent të angazhuar në mësimdhënie, teza hartohet nga titullari në bashkëpunim me asistentin. Teza firmoset nga përgjegjësi i Departamentit një ditë para provimit dhe një kopje e saj depozitohet në arkivën e departamentit.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7; Evidenca 3.25; Evidenca 3.26).</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Gjatë tre viteve të fundit akademike 2018 – 2021, testimi i vlerësimit të njohurive për programin Bachelor në “Bioteknologji” është zhvilluar në auditor dhe online.</p> <p>Në rastin e parë, është zhvilluar në mënyrë anonime me sekretim, ku sekretarja e departamentit dhe stafi ndihmës akademik realizonin sekretimin dhe kodifikimin. Bazuar në nenin 48 të Rregullores të Universitetit të Tiranës provimet me shkrim, testimet në lëndët që zhvillohen përgjatë gjithë ciklit mësimor, bëhen në fletë të sekretuara. Proçedura e sekretimit mban të fshehtë emrin e studentit në fletët e provimit gjatë vlerësimit me notë nga ana e pedagogut.</p> <p>Në rastin e provimeve online, meqë studentët logohen nëpërmjet emaileve syrtare të UT, komunikimi pedagog – student ishte i drejtpërdrejtë. Në këto kushte u aplikua testimi “online” i cili garanton transparencë dhe lehtësi në vlerësimin e studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 3.2).</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Provimet e zhvilluara me gojë realizohen në formën e një bashkëbisedimi vlerësimi-student gjatë të cilit studenti qartësohet mbi përgjigjet e dhëna dhe për aspektet shtesë që duhet të japi për të plotësuar tablon e përgjigjes në të ardhmen. Për provimet me shkrim vlerësimi i njohurive mund të shoqërohet me komente nga pedagogu në tezën e provimit, rast pas rasti, për të sqaruar studentin për vlerësimin dhe për ta ndihmuar atë që të përmirësohet në të ardhmen.</p>


	<p>Sipas rregullores së UT dhe asaj të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” brenda 5 ditëve nga dhënia e provimit, pedagogu duhet të bëjë nxjerrjen e notave. Pas kësaj, brenda 2 ditëve pune nga koha e informimit, studenti nëpërmjet një kërkesë në departament ka të drejtën të shohë fletoren e provimit dhe komentet e bëra nga pedagogu i lëndës në prani të komisionit të provimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7).</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. Komisioni i pedagogëve para fillimit të provimit me shkrim, i bëjnë të ditur studentëve se provimi është individual dhe nuk lejohet asnjë formë kopjimi. Në rast të konstatimit të kopjimit gjatë provimit, bazuar në Rregulloren e UT për zhvillimin e provimit dhe të të drejtave të autorit, studentit i tërhiqet vërejtje me gojë dhe i zerohen pikët e vlerësimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.6; Evidenca 1.7).</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Për programin Bachelor në “Bioteknologji”, vlerësimi i dijeve dhe aftësive kryhet sipas përcaktimeve në syllabuset e disiplinave ku me 45-50 pikë vëndoset nota pesë, dhe çdo dhjetë pikë vlerësimi shtohet me një notë. Sipas rregullores së UT dhe asaj të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” brenda 5 ditëve nga dhënia e provimit, pedagogu duhet të bëjë nxjerrjen e notave.</p> <p>Zhvillimi i procesit mësimor “online” nëpërmjet platformës MS-Teams, për vitet akademike 2019-2020, semestri i II-të dhe 2020- 2021 semestri I dhe II-të, mundësoi edhe zhvillimin elektronik të provimeve. Testimet “online” kanë siguruar garancinë për meritë dhe transparencë në vlerësimin e njohurive dhe dijeve të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7; Evidenca 1.9; Evidenca 3.2).</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Tezat e provimit të miratura nga Departamenti përmbajnë në kokën e tyre të dhëna rreth mënyrës së dhënies së rezultatit të provimit, datën, orën dhe vendin që studenti duhet të paraqitet për tu ballafaquar me rezultatit dhe testin e korrigjuar, së bashku me sasinë e pikëve që studenti duhet të marrë nga teza për të arritur kufirin kalues. Në rastet e provimit me gojë rezultatet jepen menjëherë pas provimit</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit.</p> <p>Pas shpalljes së rezultatit, studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim nga komisioni për vlerësimin e bërë. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale që ka marrë në provim dhe me pikët për çdo pyetje të tezës.</p>

	<i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7).</i>		
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. Nëse studenti ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit, ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit. Ai bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni Dekanin e fakultetit. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Drejtuesi i Departamentit, ngre një komision <i>ad-hoc</i>, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Të gjitha procedurat e ndjekura për çdo kërkesë ose ankimim që shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm dokumentohet dhe arkivohet.</p> <p style="text-align: center;"><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7).</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi dhe Syllabuset tregojnë që: Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” është ndër programet e avancuara ndërdisiplinore, në të gjitha drejtimet e bioteknologjive të aplikuara si: Bioteknologji Mjekësore dhe Farmaceutike, Agrobioteknologji, Bioteknologji Mjedisore, Bioteknologji Ushqimore, etj. Në këtë kuptim, ai garanton dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në një larmi fushash si në aspektin teorik, ashtu dhe në atë praktik.</p> <p style="text-align: center;"><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9).</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Programi i studimit Bachelor në “Bioteknologji” plotëson aftësitë e veçanta të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit (disiplina: Biostatistikë), në shkencat humane dhe sociale (disiplina: Bazat e Psikologjisë dhe Etikës në Bioteknologji), në fushën e komunikimit dhe të ndërveprimit (disiplina: Anglisht dhe Kulturë Gjuhe). Detajet mbi to përfshihen në syllabuset e disiplinave.</p> <p>Bashkëpunimet në kuadër të projekteve studimore dhe mësimdhënëse me universitete të ndryshme të huaj mundësojnë edhe përmirësimin e komunikimit në gjuhë teknike të huaj. Përvoja të tilla me shumë vlerë kanë përfutur edhe studentët që janë aktivizuar nga pedagogët në projekte të</p>


	<p>ndryshme ose ata që në kuadër të bursave Erasmus+ kanë zhvilluar një semestër të programit të studimit në universitete të ndryshme jashtë vendit.</p> <p><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. Në përfundim të çdo disipline të programit Bachelor në “Bioteknologji”, pedagogu i lëndës analizon mbarëvajtjen e saj së bashku me studentët bazuar në vlerësimet gjatë vitit, provimin përfundimtar dhe pyetësorët e studentëve. Sa më sipër, analizohen dhe në mbledhjet e departamenti.</p> <p><i>(Evidencat 3.7-3.10).</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre, dhe për daljen sa me më sukses në provimin përfundimtar. Në fund të semestrit që përkon me javën e fundit të mësimi, studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohen për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi si edhe për peshën që do të ketë ai në notën përfundimtare. Analizimi i mbarëvajtjes së disiplinës dhe pyetësorët e studentëve përdoren nga personeli akademik për të organizuar biseda të hapura me studentët dhe për t'i orientuar ata në implementimin e objektivave të disiplinës të përshkruara në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>(Evidenca 1.9; Evidenca 3.7; Evidenca 3.9; Evidenca 3.10).</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Departamenti i Bioteknologjisë është kujdesur në vazhdimësi për realizimin e orëve të hapura dhe seminareve mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, jashtë strukturës së programit të studimit. Për këtë kanë shërbyer Eurobiotech School 2019, Profesorat i ardhur në kuadër të Erasmus+, Profesorat i ftuar në kuadër të projekteve bilaterale.</p> <p><i>(Evidenca 2.13; Evidenca 2.13.1).</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>CV e personelit akademik tregojnë që stafi akademik i angazhuar në programin Bachelor në “Bioteknologji” është kompetent dhe i kualifikuar në disiplinat që mbulon. Në ndihmë të pasurimit të kompetencave kanë shërbyer përfshirja në projekte dhe pjesëmarrja në aktivitete shkencore dhe mobilitetet Erasmus të personelit akademik.</p> <p><i>(Evidenca 1.22; Evidenca 1.24; Evidenca 2.2; Evidenca 2.2.1).</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të</p>	<p>Syllabuset e programit tregojnë që në programin Bachelor në “Bioteknologji”, në të gjitha disiplinat, parashikohen dhe realizohen veprimtari të mbështetura në diskutimet dhe punën në grup të studentëve. Të tilla janë detyrat e kursit, seminarët dhe praktikat laboratorike. Studentët</p>

caktuara.	<p>në çdo rast inkurajohen që të interpretojnë gjetjet teorike apo rezultatet eksperimentale e të bashkëpunojnë për t'i formuluar drejtë ato.</p> <p><i>(Evidenca 1.9).</i></p>						
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. Personeli akademik i këtij programi studimi nxit zhvillimin e ideve të reja duke propozuar tematika kërkimore shkencore që realizohen mbi platformat teorike (gjatë seminareve dhe detyrave të kursit) dhe praktike gjatë laboratoreve. Kjo nxit një lidhje më të mirë të dijeve teorike me ato praktike tek studentët. Për të vlerësuar sa më sipër, studentët shprehin mendimet e tyre në pyetësorët e ofruar nga pedagogët e lëndëve në përfundim të semestrit përkatës, si dhe pyetësorët në nivel njësie kryesore, rezultatet e të cilave përdoren nga stafi akademik, ai ndihmës dhe nga autoritetet në njësitë bazë.</p> <p><i>(Evidencat 3.7-3.9).</i></p>						
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. UT ka një politikë të qartë dhe transparente për mbështetjen dhe orientimin e studentëve drejt ideve inovative dhe të avancuara duke mbështetur financiarisht Këshillat e Studentëve, veprimtaria e të cilëve në nivel fakulteti mbështetet dhe financohet nga buxheti i FSHN. Studentët e UT përfitojnë në mënyrë të përvitshme bursa, përjashtim apo reduktim të tarifës së shkollimit. Gjithashtu, studentët mbështeten edhe përmes pjesëmarrjes së tyre në programet Erasmus me Universitete që UT ka marrëveshje.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.23; Evidenca 1.29; Evidenca 3.27).</i></p>						
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>UT dhe FSHN ka një numër të madh projektesh Erasmus+ me anë të të cilëve mundësohet mobiliteti i personelit akademik për mësimdhënie si dhe e studentëve për të ndjekur semestra të tërë studimi pranë këtyre Universiteteve të huaja.</p> <p>Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT, ka marrë pjesë në pothuajse të gjitha programet Erasmus të ofruara nga marrëveshjet e UT me institucione europiane (Marrëveshjet + mobilitetet Erasmus). Falë këtyre bashkëpunimeve, mobiliteti i studentëve ka ardhur në rritje nga viti në vit.</p> <p><i>(Evidenca 1.22; Evidenca 1.23; Evidenca 1.29; Evidenca 1.30; Evidenca 2.14).</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1621 778 1693">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="778 1621 999 1693">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="999 1621 1209 1693">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1693 778 1736"></td> <td data-bbox="778 1693 999 1736"></td> <td data-bbox="999 1693 1209 1736" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final. Në rregulloren e UT trajtohet provimi final ose mbrojtja e diplomës dhe në rregulloren e Bachelor në “Bioteknologji”, studentët i nënshtrohen vetëm provimit final. Rregulloret e mësipërme dhe programi orientues i provimit të diplomës orientojnë studentët për procedurën e diplomimit. FSHN, UT, organizon tre sezone fikse (Korrik, Shtator, Mars) dhe dy të tjera nëse kërkohen nga Këshilli studentor (Prill, Tetor) për provimet përfundimtare ose punimet e diplomës, për të cilat periudha e zhvillimit përcaktohet nga dekanati dhe bëhet publik për studentët në websiten e FSHN.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7; Evidenca 2.3; Evidenca 3.21).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. Në mbështetje të studentëve që kanë shlyer detyrimet e programit Bachelor në “Bioteknologji” dhe përgatiten për provimin final, Departamenti i Bioteknologjisë harton dhe vë në dispozicion të tyre një program të detajuar për provimin final. Në përputhje me rregulloren e programit Tutorët e Bachelor I, II dhe III organizojnë takime informuese me grupet përkatëse dhe në raste kërkesash nga studentët planifikojnë organizimin e konsultimeve me pedagogë të lëndëve.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 2.17; Evidenca 3.21).</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Departamenti i Bioteknologjisë FSHN, UT, në zbatim të rregullores së UT dhe të programit të studimit ngre komision të posaçëm të provimit të diplomimit, në përbërje të secilit janë staf akademik i lëndëve me peshë specifike më të madhe të programit.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 3.25).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final. Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT, përveç përcaktimit të kriterëve për hyrjen në provimin e diplomimit të studentëve Bachelor në “Bioteknologji” harton një program të provimit të diplomimit të mbajë kontakte të vazhdueshme me studentët, veçanërisht në periudhën Mars – Qershor të çdo viti akademik, që është periudha e përgatitjes së studentëve për këtë detyrim.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 2.17; Evidenca 3.21).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve,</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT, neni 59-62, programi i studimit Bachelor në</p>

<p>analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>UT nuk aplikon temat e diplomës në përfundim të programit. Programi Bachelor në “Bioteknologji”, mbrojtjen e diplomës e realizon si provim final me shkrim dhe me gojë. Studentët asistohen gjatë të gjithë semestrit të dytë të Bachelor III për t’u përgatitur bazuar në programin e diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 3.21).</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Programi Bachelor në “Bioteknologji”, mbrojtjen e diplomës e realizon si provim final me shkrim dhe me gojë. Studentët asistohen gjatë të gjithë semestrit të dytë të Bachelor III për t’u përgatitur bazuar në programin e diplomimit. Programi i studimit përfundon/mbyllet me provimin e diplomës sipas procedurave dhe rregullave të përshkruara në kriteret 1-4 të standardit III.8.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 3.21).</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit, studenti vlerësohet me notë. Provimi i diplomës zhvillohet në prani të një komisioni të posaçëm (komisioni <i>Ad-hoc</i>) të ngritur nga departamenti dhe bazuar në pikët totale të marra nga studenti bëhet vlerësimi i tij. Nota minimale e vlerësimit është 5 dhe maksimalja është 10. Nota del si mesatare aritmetike e vlerësimit të çdo anëtari të komisionit dhe me mirëkuptim. Ky vlerësim i provimit final pasqyrohet në procesverbalet e depozituara në sekretarinë mësimore. Këto procesverbale firmosen nga të gjithë anëtarët e komisionit që kanë hartuar tezën.</p> <p><i>(Evidenca 3.25; Evidenca 3.28).</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria për arsimin dhe sportin. Studentët që shlyejnë të gjitha detyrimet e programit të studimit pajisen me diplomën përkatëse e cila shoqërohet dhe me listën e notave dhe suplementin e diplomës. Emërtimi i diplomës bëhet në përputhje me programin e studimit në mbështetje të rregullores së UT. Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit të Tiranës. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Certifikata “Medalje e Artë” dhe për studentët që gjatë studimeve, kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet Certifikata “Student i Shkëlqyer”.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidenca 2.5; Evidenca 2.6).</i></p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” dhe pas diplomimit, studenti pajiset me diplomën (përkatëse e shoqëruar me suplementin e saj). Pas diplomimit, studentit i vihet gjithashtu, në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar me syllabuset përkatëse, me kërkesën e tij.</p> <p><i>(Evidenca 2.5; Evidenca 2.6).</i></p>

<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë e FSHN u pa që Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës mban (Ligji 80/2015 neni 101):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar (bazë) të studentëve me të dhënat personale të tyre. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye; - Regjistrin e arritjeve akademike me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit; - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore. <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 3.29; Evidenca 3.30; Vizita në sekretarinë mësimore).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo</p>	<p>Në Universitetin e Tiranës, mbledhja, ruajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe njësia e saj në FShN, Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës. Dega e Burimeve Njerëzore ruan një dosje të plotë për çdo anëtar të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit me kohë të plotë apo me kontratë. Dosjet me të dhënat e personelit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 47




<p>semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>përditësohen në mënyrë periodike. Personeli akademik me kohë të plotë dorëzon pranë kësaj dege dokumentacionin e përditësuar nëse ka, ndërsa personeli akademik me kontratë dorëzon dokumentacionin çdo vit pas konkurimit dhe përzgjedhjes nga komisioni ad hoc i ngritur nga Përgjegjësi i DBT.</p> <p>Çdo fillim viti akademik përcaktohet stafi akademik dhe ngarkesa individuale semestrare dhe vjetore e çdo lektori dhe asistent lektori, që angazhohet në mësimdhënien e programit Bachelor në "Bioteknologji". Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtaritë e ndryshme përbërëse, për çdo anëtar të personelit akademik të DBT formalizohet ndërmjet Përgjegjësit të Departamentit dhe anëtarëve të personelit akademik, sipas Udhëzimit të MASR nr. 29/2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Ngarkesa akademike vjetore e çdo anëtari të stafit akademik evidentohet nëpërmjet regjistrimit të pedagogut dhe formularit të ngarkesës të firmosur nga Përgjegjësi i DBT dhe Administratori i Fakultetit. Përgjegjësi i Departamentit dhe strukturat përgjegjëse të FShN mbikqyrin zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.19; Evidenca 2.4; Evidenca 4.12; RVB Aneksë, Tabela 4; Takimi me Degën e Burimeve Njerëzore).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Punësimi në UT bëhet bazuar në legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore e nënligjore të Arsimit të Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr. 80/2015) dhe Statutit e Rregullores së UT. Sipas statutit të UT (neni 67 dhe 68), procedura e konkurimit duhet të garantojë një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Takimi me Degën e Burimeve Njerëzore).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e UT përcaktohen kriteret dhe procedurat për punësimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe me kontratë, si dhe punësimin e stafit ndihmës akademik dhe atij administrativ.</p> <p>Në nenin 67, pika 3 të Statutit të UT përcaktohen kriteret e përgjithshme të kandidatëve për t'u punësuar si staf akademik me kohë të plotë pranë UT, ndërsa sipas pikës 4 të po këtij neni, është njësia bazë, që mbështetur në nevojat e saj, përcakton kritere të veçanta shtesë për vendet e punës, mbështetur në kategorinë e personelit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga Rektori.</p> <p>Shpallja e vendit të lirë, kriteret dhe afatet bëhen publike në Buletinin e Njoftimeve nga Agjencia Kombëtare e Prokurimit Publik si edhe në faqen zyrtare elektronike të FShN. Në Statutin e UT, Neni 67, pika 7, sanksionohet se shpallja e kadidatit fitues publikohet edhe në faqen zyrtare të FShN.</p> <p><i>GVJ nuk mund të gjykojë për objektivitetin e punësimit të stafit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në "Bioteknologji", pa u njohur fillimisht me kriteret e vlerësimit të dosjeve të aplikantëve në kohën e rekrutimit të tyre, por nga shqyrtimi i dy dosjeve të personelit akademik të ruajtura në Degën e Burimeve Njerëzore FShN, e të zgjedhura në mënyrë</i></p>


	<p><i>rastësore, u vërejt se arritjet akademike universitare të tyre ishin të një niveli mesatar. Për të përmirësuar procedurat e rekrutimit të stafit akademik dhe për të shmangur problematikat (siç theksohet në Manual), UT ka miratuar Manualin mbi punësimin e personelit në UT (2022), i cili është një garanci më shumë “për një proces të ligjshëm, meritokratik e transparent për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit në UT”.</i></p> <p>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidenca 4.1; Evidenca 4.2; Evidenca 4.3; Takimi në Zyrën e Burimeve Njerëzore, FShN).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><i>Procedurat e rekrutimit dhe të vlerësimit në UT/FShN mbështeten në kritere të përgjithshme dhe specifike, që përveç të tjerash, synojnë të garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve gjykojmë që nuk duhet të jenë aq “specifike”, në kushtet kur dihet se në Shqipëri numri i specialistëve në fusha shumë specifike e me një përvojë të caktuar kohore në fushën e caktuar është shumë i vogël, për të mos thënë është vetëm një. Edhe për këtë arsye, kriteret specifike nuk duhen konsideruar kritere preferenciale, sepse kjo përjashton nga konkurimi kandidatët me arritjet më të mira akademike. Respektimi i Statutit, rregulloreve të UT në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit të stafit akademik me kohë të plotë apo me kontratë, stafit ndihmës akademik e administrativ si dhe kontrolli i respektimit të kriterëve dhe procedurave në punësimin e stafit të DBT do të siguronte përzgjedhjen e personelit me kualifikimin më të mirë në përputhje me natyrën e vendit të punës, përmbajtjen e programit të studimit dhe lëndën/lëndët specifike.</i></p> <p>(Evidenca 4.1; Evidenca 4.2; Evidenca 4.3; Takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UT dhe specifiku DBT siguron një mjedis të përshtatshëm për të gjithë personelin akademik dhe ndihmes akademik për kryerjen sa më të mirë të aktiviteteve akademike dhe kërkimore.</p> <p>Për personelin akademik ka mjedise zyrash, të pajisura me pajisje elektronike dhe internet. Për punën kërkimore në dispozicion të personelit akademik janë 7 laboratore mësimorë dhe shkencorë të DBT, por, për kërkime specifike në dispozicion të stafit të DBT janë edhe laboratorët e departamenteve të tjera të FShN. Ekzistenca e laboratorëve të profileve të shkencave të natyrës dhe bioteknologjike në distanca jo të mëdha brenda kampusit të FShN, e bën shfrytëzimin e tyre nga grupe të ndryshme kërkimore më eficient dhe nxit krijimin e grupeve kërkimore të përzjera brenda FShN.</p>


	<p>Në funksion të kërkimit dhe aktivitetit akademik, personeli akademik dhe ndihmës akademik shfrytëzon edhe librat, periodikët, etj. në formë fizike dhe online të Bibliotekës së FShN.</p> <p><i>(Evidenca 1.18; Evidenca 1.19; Evidenca 1.21; Evidenca 3.17; Evidenca 3.18; Evidenca 4.9; Takimi me stafin akademik dhe vizita në ambjete e Institucionit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Kualifikimi i stafit dhe mbështetja e tij në veprimtarinë kërkimore është objektiv i Strategjisë së Zhvillimit të UT. Në këtë kuadër është miratuar Plani i Kërkimit Shkencor në Universitetin e Tiranës (2018-2022).</p> <p>Stafi akademik i DBT mbështetet nga Institucioni për përparimin profesional të tij në mënyrë të vazhduar. UT dhe FShN nxit kualifikimin e personelit akademik, duke krijuar atyre të gjitha mundësitë dhe hapësirat e nevojshme për përparimin profesional nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe shkëmbimeve të stafit akademik me universitete ndërkombëtare, pjesëmarrjes në kurse trajnimi, konferenca dhe workshop-e, zhvillimit të leksioneve të hapura të mbajtura nga lektorë vendas dhe të huaj, programeve të shkëmbimit, si edhe projekteve të përbashkëta shkencore. Vetëm në kuadër të projektit të përbashkët të mobiliteteve Erasmus+ me Universitetin e Perugia-s, që përfundoi në fund të muajit Korrik 2022, nga DBT pati dy mobilitete stafi për trajnim dhe një për mësimdhënie.</p> <p>Kualifikimi i stafit të DBT reflektohet në 33 botime në revista të indeksuara SCOPUS dhe/ose Thomson Reuters dhe 149 referime në Konferenca shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Një listë e detajuar e marrëveshjeve bilaterale të nëshkruara nga UT gjenden edhe të publikuara në link-un https://unitir.edu.al/marreveshjet-bilaterale-2/.</p> <p>FShN planifikon çdo vit fonde të veçanta në buxhet për mbështetje financiare të stafit për zhvillimin profesional të tij. Si përfitues i marrëveshjeve dhe financimeve të përmendura më sipër, DBT ka rritur nivelin e kualifikimit të stafit të tij.</p> <p><i>(Evidenca 1.2; Evidenca 1.22; 1.24; 2.14; 1.30; Evidenca 2.2; Evidenca 4.4; Evidenca 4.5; RVB Aneks, Tabela 19).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në funksion të përmbushjes së objektivave të strategjike të UT në lidhje me mësimdhënien, FShN dhe DBT mbështetin stafin akademik në diversifikimin e strategjive të mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve edhe nëpërmjet përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies. Në këtë kuadër, UT ka hartuar një rregullore për zhvillimin e mësimin në distancë, ka vënë në dispozicion të përdoruesve udhëzues të përdorimit të platformave online, si edhe ka realizuar trajnimin e stafit për mënyrën online të zhvillimit të procesit mësimor dhe provimeve.</p> <p><i>(Evidenca 1.2; Evidenca 3.1-3.3).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Në programin Bachelor në “Bioteknologji” është i angazhuar në mësimdhënie stafi akademik efektiv dhe me kontratë i DBT dhe i departamenteve të tjera të FShN ose fakulteteve të tjera.</p> <p>I gjithë personeli akademik efektiv i DBT është i përfshirë në mësimdhënie në nivelin e parë të studimeve Bachelor në Bioteknologji. Ngarkesa</p>

	<p>mësimore e stafit akademik efektiv të DBT e kalon normën vjetore të ngarkesës në auditor të parashikuar në Udhëzimin 29, datë 10.09.2018, të Ministrit të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”. Për të zhvilluar orët e pambuluara mësimore nga stafi efektiv, në programin e studimit Bachelor në Bioteknologji janë angazhuar edhe pedagogë me kontratë. Për vitin akademik 2021-2022, GVJ evidenton se nga 17 pedagogë me kontratë të përfshirë në mësimdhënie në programin Bachelor në Bioteknologji, 9 janë rekrutuar nga DBT për lëndët ose modulet që ofrohen nga ky departament për këtë program, me orë auditori që variojnë nga 28 në 120. Raporti pedagogë me kontratë/pedagogë efektivë është 0.9, pra gati për çdo pedagog efektiv ka edhe një pedagog me kontratë. GVJ sugjeron se lëndë të vogla me pak orë (28 orë) mund të shpërndahen në ngarkesën e stafit efektiv, më konkretisht në ngarkesën e titullarit të lëndës (me titull Prof. apo Prof. As.), dhe se do të ishte në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, zgjerimi i kapacitetit akademik të DBT me staf efektiv dhe kufizimi i numrit të stafit akademik me kontratë, duke rritur orët e ngarkesës së stafit efektiv, brenda kufizimeve ligjore. Angazhimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së vënë në dispozicion për programin Bachelor në “Bioteknologji” kanë mundur përmbushjen e objektivave të këtij programi.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.25 shtesa, Tabela 6.4; Evidenca 3.14 shtesa, Tabelat 12; Evidenca 2.4; Evidenca 3.14; RVB, Aneks, Tabela 4, fq.19-26; RVB, Aneks, Tabela 9, fq.34).</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 1010 774 1081">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="774 1010 997 1081">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="997 1010 1428 1081">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 1081 774 1128"></td> <td data-bbox="774 1081 997 1128"></td> <td data-bbox="997 1081 1428 1128" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” janë në dispozicion salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorë mësimorë të shpërndara në godinat e FShN. Në dispozicion të procesit mësimor, studentët dhe stafi i përfshirë në mësimdhënie në Programin Bachelor në “Bioteknologji” ka në dispozicion Bibliotekën e FShN si edhe sallat e saj të leximit.</p> <p>Në nivel fakulteti, është vlerësuar se raporti sipërfaqe/student është 5.3 m², raport që kalon standardin e përcaktuar në Vendimin nr. 418 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.</p> <p>Mjediset, në të cilat zhvillohen veprimtaritë teorike të programit mësimor, janë të bollshme dhe bashkëkohore.</p> <p>Laboratorët mësimorë janë të pajisur mjaftueshëm me pajisje bashkëkohore</p>

	<p>laboratorike, duke siguruar plotësimin e objektivave të veprimtarisë praktike të lëndëve shkencore. Numri i studentëve në grupet laboratorike është 15-16 studentë. Kjo, jo vetëm i siguron atyre hapësirën e nevojshme dhe sigurinë në punë, por lejon që punët të kryhen individualisht me mjetet dhe pajisjet në dispozicion.</p> <p><i>(Evidenca 1.18; Evidenca 1.21; Evidenca 3.17; Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore ku zhvillohen veprimtaritë mësimore të programit Bachelor në “Bioteknologji” janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Po ashtu në shërbim të studentëve dhe stafit janë platforma të bibliotekave online, të cilat mund të aksesohen lehtë. I gjithë kampusi i FShN është i lidhur me shërbim interneti.</p> <p><i>(Evidenca 1.18; Evidenca 3.18; Vizita e ambjenteve në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët mësimorë në funksion të programit të studimit janë të pajisur me mjete dhe pajisje laboratorike të mjaftueshme për plotësimin e veprimtarive laboratorike të lëndëve, që i parashikojnë ato në programet e tyre. DBT ka një infrastrukturë laboratorike bashkëkohore, e cila pasurohet vazhdimisht, falë edhe financimit nga projektet kombëtare dhe ndërkombtare të fituara nga DBT.</p> <p>Vetë institucioni kryen gjithashtu investime në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës laboratorike dhe furnizmin me reagentë e materiale laboratorike konsumi. <i>Mbështetur në numrin e laboratorëve, pajisjet laboratorike dhe volumin e punës që kryhet në ato, laboratorëve të DBT i duhej dedikuar një sipërfaqe më e madhe dhe, për arsye sigurie, edhe e ndarë fizikisht nga sallat e mësimin.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.21; Evidenca 1.24; Evidenca 2.14; Evidenca 4.6-4.8; Vizita e ambjenteve në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” janë tre laboratorë të teknologjisë së informacionit: dy Laboratorë të Teknologjisë së Informacionit (Departamenti i Informatikës) dhe Laboratori i Biostatistikës (Departamenti i Biologjisë). Të tre laboratorët janë të pajisur me kompjutera personalë dhe me software dhe një seri programesh dhe paketash profesionale.</p> <p><i>(Evidenca 1.18; RVB, fq. 55; Vizita e ambjenteve në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” nuk parashikohen praktika profesionale. Institucioni në shërbim të zhvillimit të praktikave mësimore e veprimtarive të tjera praktike të parashikuara në programin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji”, bashkëpunon me institucione shtetërore e private me të cilat ka marrëveshje të formalizuara.</p> <p><i>(Evidenca 1.30; Evidenca 1.31).</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” është Biblioteka e FShN, e cila funksionon mbështetur në Rregulloren e saj. Biblioteka ka 92 poste/vende studimi në mjedisin e Fondit të Hapur të Librit dhe 44 vende pune në Fondin e Hapur të Periodikut. Biblioteka ka një fond librash e periodikësh në shqip e gjuhë të huaj, që shfrytëzohen nga studentët dhe stafi në ambientet e bibliotekës dhe jashtë saj. Biblioteka pasurohet periodikisht me tituj të rinj, që financohen nga buxheti i FShN, projekte të ndryshme dhe dhurime. FShN boton revistën e tij “Buletini i Shkencave të Natyrës” ⁶ , që publikohet edhe online dhe është e hapur. <i>(Evidenca 3.16; Evidenca 3.17; Vizita në Bibliotekën e Institucionit).</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e FShN ka në fondin e saj rreth 80,018 tituj në dispozicion të të gjithë programeve të studimit që zhvillohen në këtë fakultet. Prej tyre 36600 njësi janë libra e monografi shkencore dhe 24,451 njësi revista e periodikë shkencorë. Të tjerat janë dizertacione që ruhen në Fondin e Bibliotekës. Në bibliotekë ofrohet literatura bazë në formë fizike për pjesën më të madhe të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji”. Një tirazh i caktuar i teksteve mësimore të miratuara për programin Bachelor në “Bioteknologji” gjenden në Bibliotekën e FShN. Ky tirazh është i ulët, krahasuar me kërkesën e studentëve për këtë literaturë. Kjo situatë mund të zgjidhet kur vetë universiteti të marrë përsipër financimin për botimin dhe shtypshkrimin e literaturës bazë mësimore. <i>(Evidenca 3.20; Vizita në Bibliotekën e Institucionit).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Biblioteka FSHN ofron literaturë online falë dixhitalizimit të katalogut bibliografik dhe marrëveshjeve për shfrytëzimin e bibliotekave digjitale si JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP. Aksesit në to mund të realizohet përmes faqes elektronike zyrtare të UT dhe FSHN Studentët kanë akses pa pagesë në bibliotekën on-line ULIBRARY dhe sistemin bibliotekar on-line COBISS (http://www.al.cobiss.net/). <i>(Evidenca 3.18; Evidenca 4.10; RVB, fq. 56).</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë	Në bibliotekën e FShN, numri i kompjuterave personalë me akses në internet dhe burimet online të literaturës është i kufizuar, gjë që kufizon shfrytëzimin e literaturës online nga studentët që nuk disponojnë një kompjuter. Nisur nga ky fakt, duhet të konsiderohet mundësia e pajisjes së

⁶ <https://fshn.edu.al/notifications/botimi-nr-29-viti-2020>

studentëve.	<p>sallave të studimit në bibliotekë me kompjutera e internet, në mënyrë që studentët të mund të kërkojnë literaturën dhe të shfrytëzojnë periodikët e librat on-line. Gjithashtu do të ishte avantazh për studentët, që të paktën një nga sallat e leximit të ishte e pajisur me kompjutera që ata t'i shfrytëzonin për të përgatitur detyrat.</p> <p><i>(Evidenca 3.17; Vizita e ambjenteteve në Institucion).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Pasurimi i Bibliotekës së FShN bëhet duke u bazuar në kërkesat për literaturë shkencore të paraqitura nga njësitë bazë të fakultetit, përpara miratimit të buxhetit, përmes planifikimit të një zëri të veçantë në buxhetin e universitetit dhe atë të fakultetit. Pasurimi kryhet edhe përmes zërave të shpenzimeve për literaturë të projekteve të ndryshme, si edhe përmes dhurimeve.</p> <p>Biblioteka shkencore e FSHN, UT përcjell informacion tek personeli akademik dhe ndihmës akademik lidhur me hyrjet e reja të literaturës dhe veprimtari të ndryshme që zhvillohen me referencë arkivat e saj.</p> <p>Në DVV e përcjellë janë prezantuar vendimet për miratimin e buxhetit të UT për tre vite, në të cilat është specifikuar edhe fondi për blerje librash e peridikësh, përfshirë edhe gazeta, etj., por nuk jepet se sa janë titujt e librave dhe periodikëve shkencorë të blerë. Gjithsesi GVJ mendon se abonimi periodik në biblioteka online, siguron mjaftueshëm nevojat për literaturë të huaj për studentët e nivelit Bachelor.</p> <p>Në funksion të programit të studimit, tekstet mësimore bazë për lëndët që mbahen nga stafi i DBT janë pjesë e fondit ekzistues të bibliotekës të depozituar me vullnetin e lirë të pedagogëve.</p> <p><i>(Evidenca 3.20; Evidencat 4.6-4.8; Evidenca 4.10; RVB, fq. 57).</i></p>		
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e FSHN qëndron e hapur nga dita e Hënë në ditën e Premte, sipas orareve të bëra publike. Biblioteka funksionon përmes kartelave të regjistrimit dhe aksesit i të gjithë studentëve është i pa kufizuar për të gjitha shërbimet që ofrojnë bibliotekat. Vetëm në periudhën 1 Tetor 2019 – deri në 30 Shtator 2020 biblioteka u përdor nga 37,984 vetë.</p> <p><i>(Evidenca 3.17; RVB, fq. 57; Vizita në Bibliotekë).</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brengshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e</p>	<p>Administrimi i informacionit/bazës së të dhënave të studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” kryhet nga Sekretaria Mësimore e FShN. Ajo mban në formë të shkruar dhe elektronike Regjistrin themeltar të studentëve dhe Regjistrin e arritjeve akademike të studentëve. Sekretaria mësimore administron dhe arshivon në mënyrë periodike, së</p>

studimit.	<p>bashku me dokumentat e sipërpërmendur edhe dosjet personale të studentëve, procesverbalet e vlerësimeve të provimeve, regjistrin e diplomave, dokumentacionin e procedurave të transferimit, çrregjistrimit, ndërprerjes apo rifillimit të studimeve.</p> <p>Sekretaria Mësimore e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e UT, dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Të gjithë studentët e FShN si edhe stafi akademik, ndihmës akademik, e administrative zotërojnë një adresë zyrtare email-i me domenin e Universitetit (.ut) ose Fakultetit (.fshn). Kjo lehtëson komunikimin e studentëve ndërmjet tyre dhe zyrtarizon komunikimet e tyre me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidencat 3.12.1-3.12.5; Evidenca 3.28-3.30; Evidenca 4.11; Evidenca 5.1; Takimi me Sekretarinë Mësimore).</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik (efektiv dhe me kontratë), ndihmës akademik dhe administrativ në UT dhe FShN janë Drejtoria e Burimeve Njerëzore (UT) dhe Njësia/Dega e Burimeve dhe ajo e Protokoll-Arshivës.</p> <p><i>(Evidenca 1.19; RVB, fq. 60).</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit të FShN i siguron studentëve, personelit akademik dhe ndihmës akademik akses të dedikuar dhe konfidencial dhe ruajtje të të dhënave personale. Personeli akademik, ndihmës akademik, punonjësit administrativë dhe studentët disponojnë llogaritë e tyre personale në domen-in e FShN. Faqja zyrtare e internetit të FShN (https://unitir.edu.al/fakulteti-i-shkencave-te-natyres/) në shqip dhe në anglisht përmban informacione të përditësuara për strukturën akademike, programet e studimit, planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve të programeve të studimit, strukturën dhe oraret mësimore, njoftime të ndryshme me natyrë administrative, akademike, sportive, etj.</p> <p><i>(Evidenca 5.12; Evidenca 5.13).</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Komunikimi interaktiv dhe shkëmbimi i informacionit midis studentëve dhe personelit të departamentit dhe fakultetit mundësohet nëpërmjet platformës Microsoft Teams. Platforma MS Teams mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Në këtë platformë stafi akademik ngarkon leksionet, prezantimet e tyre, literaturën shtesë/artikuj, bën njoftime, etj. Ndërkohë studentët e përdorin jo vetëm për të marrë informacionin nga pedagogët, por edhe për të ngarkuar detyrat, detyrat e kursit, etj., si edhe për pyetje e sqarime.</p> <p><i>(Evidenca 3.1- 3.3; RVB, fq. 61).</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nëpërmjet llogarive personale të stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve mundësohet deri në një masë të caktuar monitorimi i aktivitetit akademik e administrativ. Përdorimi i platformave MS Teams dhe Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Studentit mundëson një komunikim më intensiv dhe qarkullim më të shpejtë të të dhënave dhe të informacionit.</p>




	<i>(Evidenca 3.3; Evidenca 4.11; RVB, fq. 61).</i>		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të FShN në shqip dhe anglisht. (https://unitir.edu.al/fakulteti-i-shkencave-te-natyres/) (https://unitir.edu.al/eng/)		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Me miratimin e programit të transparencës, UT publikon informacionet dhe raportet mbi buxhetin dhe të dhënat financiare. Fakulteti i Shkencave të Natyrës publikon buxhetin e tij i cili pasqyron planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të gjitha ciklet e studimit. Tarifa e shkollimit për programin Bachelor në “Bioteknologji” miratohet nga Bordi i Administrimit të UT sipas vendimeve e rregulloreve në fuqi. <i>(Evidenca 1.1; Evidenca 4.6; Evidenca 4.7; Evidenca 4.8; Evidenca 4.15).</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	DBT propozon një projekt buxhet vjetor i cili pasqyrohet në projekt buxhetin e FShN dhe të UT. Ky projekt buxhet përmban zëra të ndryshëm buxhetorë nga pajisje laboratorike, reagentë e mjete laboratorike, pajisje elektronike, kancelari, buxhet të dedikuar për praktikatat e studentëve, buxhet për botime e për pjesëmarrje në konferenca, si edhe për mirëmbajtje e riparime. Plani i financimit është edhe në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në Bioteknologji. FShN dhe UT përgatit bilance vjetore në të cilat pasqyrohet gjendja financiare, kapacitetet për situatën financiare, numrin e studentëve dhe gjenerimin e të ardhurave. <i>(Evidenca 4.6; Evidenca 4.7; Evidenca 4.8; Evidenca 4.14; RVB, fq. 62).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifët e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Sektori i Auditimit të Brendshëm realizon kontrollin dhe auditimin e brendshëm në mënyrë periodike në përputhje me rregulloret. Ky auditim është i përvitshëm dhe vlerëson e dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raportet financiare të paraqitura në kuadër të programit të transparencës përmbajnë informacion të detajuar mbi të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare. UT, sipas ligjit i nënshtrohet dhe auditimit të jashtëm financiar nga KLSH dhe MASR. <i>(Evidenca 1.1; Evidenca 4.15; Evidenca 4.7; Evidenca 4.8; RVB, fq. 62).</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 56

<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo viti, raportet dhe analizat financiare të përpiluara nga universiteti arshivohen në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë-protokollin. Raportet dhe analizat financiare përshkruajnë periudha vjetore (viti në vijim dhe vitet paraardhëse) dhe janë të publikuara dhe në faqen zyrtare të universitetit (https://unitir.edu.al/buxheti-plani-i-shpenzimeve-per-vitin-financiar-ne-vijim-dhe-vitet-e-kaluara/).</p> <p>Bazuar në analizat financiare, për garantimin e mbarëvajtjes së programeve të studimit planifikohen në buxhetet afatmesme ndërhyrje të posaçme.</p> <p><i>(Evidenca 4.15; Evidenca 4.19; RVB, Anekse, Tabela 18).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Bordi i Administrimit të UT miraton buxhetin e UT, mbështetur në kërkesat buxhetore njëjshme kryesore me qëllim përmbushjen e misionit të tyre dhe arritjen e objektivave strategjike. UT garanton qëndrueshmërinë financiare nëpërmjet: 1) Grantit të përcjellë nga MASR; 2) Të ardhurave nga tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit etj; 3) Të ardhurave nga shërbime të tjera që ofron institucioni.</p> <p>UT ka të ardhura financiare të mjaftueshme për realizimin e objektivave dhe misionit të tij.</p> <p><i>(RVB, fq. 63; Anekse, Tabela 18).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Aktiviteti akademik i studentëve të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” mbështetet në aspekte të ndryshme të tij nga legjislacioni i UT dhe Rregullorja e programit të studimit. Kjo e fundit parashikon të gjitha kërkesat e programit, procedurën e diplomimit si dhe elementët mësimorë të programit.</p> <p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” kanë mbështetjen e stafit akademik dhe ndihmës akademik të DBT. Kujdestarët e kurseve ose kujdestarët akademik sipas përcaktimit të Statutit të UT, i orientojnë ata gjatë periudhës së studimeve dhe zyra e karrierës i orienton për mundësitë e thellimit të njohurive në nivele më të larta studimi ose drejt</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 57

	<p>tregut të punës, si edhe ndjek ata pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.7; Evidenca 2.17; Takimi me Zv.Dekanan për mësimin; Takimi me studentët e programit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha politikat dhe procedurat që aplikon UT bazohen në legjislacionin në fuqi dhe garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, pa diskriminuar asnjë, pavarësisht origjinës, racës, përkatësisë fetare, gjinisë, etj. Të drejtat e studentëve, përfshirë edhe të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur në organet kolegjiale të UT, ashtu si edhe detyrimet e tyre sanksionohen në Statutin e UT. Kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit, mënyrat e vlerësimit, diplomimit, etj., janë të përshkruara me hollësi dhe duke qenë se janë transparente dhe të kontrollueshme në disa hallka, shmangin maksimalisht diskriminimin.</p> <p>DBT garanton barazinë e studentëve në marrjen e informacionit shkencor dhe në veprimtaritë e tjera formuese të programit; pjesëmarrjen në aktivitete shkencore në aplikimin për bursa studimi në FSHN dhe reduktim të tarifës së shkollimit, në aplikimin për bursa Erasmus apo bursa të tjera mobiliteti, në mundësinë e ankimimit për vlerësimin në provim, etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.31; RVB, fq. 65).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Procedurat e përzgjedhjes dhe të pranimit të studentëve në programin e studimit Bachelor në "Bioteknologji" janë të qarta për të interesuarit dhe mund të aksesohen online nga publiku, nëpërmjet publikimit të tyre online. Studentët e nivelit Bachelor në "Bioteknologji" ishin në informuar për programin e studimit, madje që përpara se të zgjidhnin preferencat e tyre për studimet universitare. Këtë informacion ata e kishin siguruar përgjithësisht direkt përmes faqes zyrtare të internetit të FSHN, ose e kishin aksesuar atë përmes portalit UAlbania. Një pjesë e tyre e kishin marrë këtë informacion nga shkolla e mesme e një pjesë përmes të njohurve. Studentët gjithashtu ishin përgjithësisht të informuar për procedurat e vlerësimit dhe të ankimimit për vlerësimin, ato të transferimit të studimeve, të aplikimit për programe shkembimi, etj. Studentët e njihnin dhe kishin kontakt me kujdestarin/tutorin e kursit dhe pranonin rolin e rëndësishëm të tyre në sqarimin e procedurave dhe në këshillim.</p> <p><i>(Evidenca 2.17; Takimi me studentët e programit të studimit; https://unitir.edu.al/fakulteti-i-shkencave-te-natyres/).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Hartimi i kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve që pranohen për të studiuar në programin e studimit Bachelor në "Bioteknologji" dhe kuotat përcaktohen nga DBT dhe miratohen në Dekanatin e FSHN dhe Senatit Akademik të UT. Kriteret e përzgjedhjes hartohen në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 295/2019 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë...", Udhëzimit të përvitshëm të MASR (Udhëzimi i MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019) "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë",</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 58

	<p>Udhëzimit nr. 17, datë 30.07.2019 të MASR “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019”, si edhe në Rregulloren e UT. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në faqen e FShN dhe në portalin UAAlbania (https://ualbania.al/).</p> <p>Studentët fitues në programin Bachelor në “Bioteknologji” përzgjidhen nga DBT dhe miratohen nga Dekani, sipas procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore të përmendura më sipër.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7; Evidenca 1.11; Evidenca 1.26).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për përzgjedhjen e studentëve në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të MASR dhe ato të Maturës Shtetërore. Kriteret specifike dhe koeficientët e vlerësimit hartohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani dhe Senati Akademik. Kuota të veçanta studimi përcaktohen për disa kategori studentësh. Programi i studimit Bachelor në Bioteknologji ofrohet në Shqip, ai është i hapur për studentët joshqipfolës, nëse ata dëshmojnë njohuri të mira të shqipes.</p> <p><i>(Evidenca 1.11; RVB, fq. 67).</i></p>		
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UT dhe FShN shpall kalendarin e informimit për maturantët me kërkesat dhe kriteret e përzgjedhjes për programet e studimit. Sipas këtij kalendari, departamentet organizojnë aktivitete informuese për maturantët e interesuar, në formën e takimeve të hapura dhe prezantim me mjediset e departamentit. Në këtë kuadër UT ka botuar Broshurën “Ditët e Informimit të Maturantëve”. Gjatë periudhës së pandemisë disa aktivitete informuese u zhvilluan online në platformën Google Meet https://meet.google.com/vgd-ohbdewknw.</p> <p><i>(Evidenca 5.4-5.6; Evidenca 5.8).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në zbatim të Rregullores të UT dhe Rregullores së Programit të studimit institucioni, FShN/DBT bën publik informacionin në lidhje me programin e studimit, përfshirë edhe rregulloren e programit dhe atë të diplomimit. Studentëve i’u vihet në dispozicion i gjithë informacioni që lidhet me Rregulloren e programit të studimeve dhe funksionimin e strukturave të FShN.</p> <p>Gjithashtu, çdo fillim viti akademik studentët e programit të studimit takohen me Përgjegjësin e Departamenteve dhe stafin akademik të departamentit, ku nëpërmjet tyre njihen më gjerësisht me programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 59

	<p>mundësitë që ofron çdo program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, diplomimin, etj. Informacion më të hollësishëm për programet e lëndëve, veprimtaritë mësimore, mënyrën e vlerësimit, detyrimet e studentit, literaturën, etj., studentët e marrin nga lektorët e lëndëve përkatëse. Informacion të pasur studentët mund ta gjejnë në faqen elektronike të FSHN.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.7; Evidenca 5.8; Evidenca 5.9; RVB, Aneksë, Tabela 14).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>DBT, në bashkëpunim me degën mësimore/të kurrikulave informon studentët për kriteret dhe procedurat e njohjes se studimeve të mëparshme të plota apo të pjesshme.</p> <p><i>(RVB, fq. 69; Faqja zyrtare elektronike e FShN).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit janë shumë mirë të informuar me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe të ankimimit. Ata janë njohur me këto procedura në takimin prezantues me drejtuesin dhe stafin e departamentit, nga lektorët për lëndët specifike dhe pedagogu kujdestar i kursit.</p> <p><i>(Takimi me studentët e programit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e programit Bachelor në “Bioteknologji” janë të informuar për procedurën e provimit përfundimtar të diplomimit. Studentëve i’u vihet paraprakisht në dispozicion programi i provimit.</p> <p><i>Në studimet Bachelor në “Bioteknologji” nuk aplikohet mbrojtja e një punimi diplome për studentët që e kalojnë prägun e arritjeve akademike. Ekziston një mospërputhje midis Rregullores së Diplomimit dhe Rregullores së Studimeve Bachelor në “Bioteknologji” në lidhje me diplomimin nëpërmjet zhvillimit të një punimi të pavarur. Ndërkohë që Rregullorja e Diplomimit, UT/FShN, sanksionon në nenin 4 që “përmbyllja e detyrimeve të programit të studimeve të ciklit të parë, bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar”, Rregullorja e Studimeve Bachelor në Bioteknologji megjithëse pranon se diplomimi i përmbahet rregullores së UT për diplomimin, në nenin 19 të saj i jep të drejtën studentëve ekselentë, me propozim të tyre dhe miratim të departamentit, të pregatisin një punim të pavarur”. Ndërkohë, Statuti i UT dhe Ligji i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (neni 73 paragrafi 2) i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet edhe duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.7; Evidenca 5.9; Evidenca 3.5B_shtesë).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UT dhe FShN shpall kalendarin e informimit për maturanët. Sipas këtij kalendari, DBT organizon aktivitete informuese për maturanët dhe publikun e interesuar.</p> <p>UT dhe FShN informon maturanët e interesuar edhe përmes faqes elektronike (https://fshn.edu.al/; https://fshn.edu.al/info/kritere), ku të interesuarit kanë mundësinë të informohen rreth programit të studimit, kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të çdo programi studimi, të drejtat dhe detyrat e studentit, etj.</p>

	<i>(Evidenca 5.2; Evidenca 5.5; Evidenca 5.6).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” studentët informohen në disa rrugë. Ata marrin informacion për programin nga (1) faqja zyrtare elektronike e FShN, përmes të cilës informohen edhe për lëndët, programin e lëndëve, nr e ECTS, detyrimet semestrale/vjetore. Ky informacion është i aksesueshëm përgjatë gjithë vitit akademik; (2) Takimit prezantues me drejtuesin dhe stafin e DBT, gjatë të cilit ata njihen me lektorët e lëndëve të semestrit të parë të studimeve, organizimin e programit dhe rregulloren e studimeve; (3) Nëpërmjet lektorëve të lëndëve çdo fillim semestri përgjatë tre viteve të studimit. Lektorët në mënyrë specifike informojnë studentët për programin e lëndës, veprimtaritë mësimore në kuadër të lëndës, detyrimet e studentit, mënyrën e vlerësimit, prezantojnë literaturën bazë dhe atë plotësuese, etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.8; Aneks, Tabela 14; Takimi me studentët e programit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni mbi programin e studimit, plani mësimor, lëndët, veprimtaritë formuese, planet mësimore/syllabuset e lëndëve studentëve i'u vihen në dispozicion në formë të printuar, si broshura apo online.</p> <p><i>(Evidenca 1.8; Evidenca 1.9; Evidenca 5.9).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Si përpara fillimit të studimeve, ashtu edhe gjatë periudhës së studimeve studentët marrin informacion nga strukturat përgjegjëse të UT dhe FShN për mundësitë e punësimit. Në kuadër të orientimit në tregun e punës, studentët asistohen nga specialistët e degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, FShN, por edhe nga stafi akademik i DBT për mundësinë e ndjekjes së studimeve të ciklit të dytë në programe që përshtaten me objektivat e tyre profesionale, me arritjet akademike dhe mundësisë së punësimit.</p> <p>Studentët asistohen nga zyra e karrierës dhe stafi akademik për aplikimin në “platformën e punësimit të studentëve ekselentë” (https://www.dap.gov.al/vende-vakante/ekselenca).</p> <p><i>(Evidenca 6.2; Takimi me studentët e programit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,</p>	<p>Përveç informacionit mbi programin mësimor dhe çështje që lidhen me të, në takimin prezantues me drejtuesin dhe stafin e DBT dhe në fillim të çdo semestri, studentët informohen nga lektorët e lëndëve të atij semestri dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 61

logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	stafi ndihmës akademik për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të procesit mësimor. <i>(Evidenca 1.7; Evidenca 1.8).</i>		
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Publikimi i informacionit në lidhje me programin e studimit në internet (faqja zyrtare e FShN), informacion që është aktiv gjatë gjithë vitit, e bën atë lehtësisht të aksesueshëm nga studentët dhe të interesuarit e tjerë, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Aksesi tek informacioni dhe mirëmbajtja e faqes dhe rrjetit, bëri që gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, FShN të menaxhojë në mënyrë perfekte zhvillimin e mësimit dhe provimeve online. <i>(Evidencat 3.1-3.3).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Sekretaria mësimore e FShN administron të dhënat e studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve. Sekretaret mësimore për çdo fushë studimi të FShN janë të ndara. Studentët e programit Bachelor në Bioteknologji nisin kontaktin me sekretarinë mësimore që në momentin e regjistrimit dhe në vazhdim deri në marrjen e diplomës. Sekretaria mësimore administron në regjistrat themeltarë, përveç numrit të matrikullimit, edhe të dhënat personale, edhe ID e Maturës Shtetërore, si dhe të dhëna në lidhje me studimet parauniversitare ose studimet pararendëse universitare nëse kanë të tilla. Informacioni i ruajtur në regjistrat fizikë (regjistrin themeltar dhe atë të notave apo arritjeve akademike) ruhet edhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore të FShN, GVJ zgjodhi në mënyrë rastësore dy studentë të programit Bachelor në Bioteknologji dhe verifikoi të dhënat e tyre në dokumentat e regjistrimit, në regjistrin themeltar dhe atë të arritjeve akademike. I gjithë informacioni përkonte, ishte i plotë dhe i ruajtur sipas kërkesave të rregullores. Po ashtu, nga verifikimi u konstatua se informacioni në procesverbalet e provimeve dhe regjistrin e notave përkonte plotësisht. Veprimtaria e Sekretarisë Mësimore mbështetet në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore të FShN. FShN nëpërmjet sekretarisë mësimore prodhon dhe administron statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji”, të diplomuarit, tërheqjet nga programi, rifillimet e studimeve, transferimet, etj. <i>(Evidenca 3.29; Evidenca 3.30; Evidencat 2.11.1 – 2.11.5; RVB, Anekse,</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 62

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Tabela 21; Vizita në Sekretarinë Mësimore të FShN). Sekretaria mësimore e FShN ruan dhe administrojnë të dhënat mbi ecurinë e studentëve të programit Bachelor në “Bioteknologji”, që nga pranimi deri në diplomim. Këto të dhëna regjistrohen në regjistrin themeltar të studentëve dhe bëhen pjesë e raporteve të ndryshme për ecurinë e procesit mësimor të programit të studimit në veçanti dhe veprimtarinë mësimore të FShN në përgjithësi.</p> <p><i>(Evidenca 1.27; Evidenca 3.29; Takimi me sekretarinë mësimore).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore për ecurinë akademike të studentëve ruhen dhe administrohen nga sekretaria mësimore e FShN, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji”. Këto të dhëna ruhen në formën e regjistrave fizikë dhe në formë elektronike. Ato janë të sigurta dhe lehtësisht të aksesueshme. Të dhënat në formë elektronike të arritjeve akademike të studentëve janë reflektim i procesverbaleve fizike të provimeve të firmosura nga komisioni i provimit. Të dhënat personale, ato të arritjeve akademike, etj., janë konfidenciale dhe si të tilla janë të aksesueshme vetëm nga persona të autorizuar. Ecuria akademike e studentëve në lëndë të caktuara mbahet nga pedagogu në regjistrin e tij të lëndës, i cili është një dokument që evidenton zhvillimin e orës së mësimit nga ai, frekuentimin e orës së mësimit nga studentët si dhe vlerësimin e njohurive të tyre.</p> <p><i>(Evidenca 3.28; Takimi në sekretarinë mësimore).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>DBT dhe FShN kryen analiza periodike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në fillim dhe fund të studimeve Bachelor në “Bioteknologji”. Këto analiza janë pjesë e raporteve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të hartuara nga departamentet dhe dekanati i FShN. Të dhënat mbi nivelin dhe cilësinë e punësimit të studentëve jepen në reportet e sipërcituara, si edhe në një studim mbi problematikën e punësimit të studentëve të diplomuar në UT të publikuar në vitin 2017.</p> <p><i>(Evidenca 1.10; Evidenca 1.12; Evidenca 1.27; Evidenca 1.32).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët e Universitetit të Tiranës ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes në strukturat vendimmarrëse e këshilluese të universitetit, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për arsimin e lartë, si edhe statutin dhe rregulloren e UT. Studentët organizohen në Këshilla Studentorë dhe kanë përfaqësuesit e tyre në Senat dhe Komisionet e përhershme të UT.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nëpërmjet garantimit të një procesi zgjedhor të lirë e të ndershëm dhe pa ndërhyrje nga stafi akademik, të përfaqësuesve të studentëve në strukturat vendimmarrëse e këshillimore të universitetit, automatikisht institucioni garanton përcjelljen e opinionit të studentëve në strukturat vendimmarrëse.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Evidenca 3.15; Anekse, Tabela 24).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi mësimor i programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” ka një ngarkesë akademike në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 41/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Ngarkesa e studentëve shpërndahet brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Njohja e plotë apo e pjesshme e studimeve të mëparshme rregullohet me aktet e brendshme rregullatore. Sistemi elektronik i të dhënave të studentëve ka shkurtuar procedurat e njohjes së studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.4; Takimi me sekretarinë mësimore).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët, si pjesë e komisioneve të përhershme institucionale (Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përkatësisht në nivel IAL dhe njësie kryesore) janë përçues të mendimit të forumeve studentore mbi organizimin dhe planin mësimor të programeve të tyre të studimit. Në kuadër të riorganizimit të programit, apo kur ai i nënshtrohet ndryshimeve më të vogla, opinionin e studentëve tërhiqet nëpërmjet pyetësorëve dhe reflektohet në programin mësimor të rishikuar. Por, studentët ndihen të lirë të shprehen hapur në komisione dhe në kontakte me pedagogë, për kërkesat në lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 3.15; Evidencat 3.4-3.9; Takimi me studentët e programit).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>E drejta e studentëve për marrjen e informacionit për vlerësimin në kontrollin e dijeve sanksionohet në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Studenti ka të drejtë të njihet me provimin pas korrigjimit dhe të ankimojë vlerësimin brenda 48 orëve nëse nuk është dakord me të. Studenti rezervon të drejtën e ankimimit edhe nëse nuk është dakord me procedurën e kontrollit të dijeve.</p> <p><i>(Evidenca 1.4; Evidenca 1.7; Takimi me studentët e programit).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të</p>	<p>Në shërbim të informimit të studentëve të programit Bachelor në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 64




informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>“Bioteknologji” janë DBT, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, Sekretaria mësimore, Dega e Financës dhe Kontabilitetit, Dega e IT dhe Statistikës, stafi akademik dhe ndihmës akademik i DBT.</p> <p>Institucioni ofron kanale të ndryshme informimi: informacionin studentët e sigurojnë nëpërmjet takimeve informuese dhe personale; me mjete informimi si guida, broshura, fletëpalosje informative, etj., dhe me anë të mjeteve elektronike të informimit (faqja zyrtare e internetit të FShN, email, platforma të ndryshme).</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.19; Evidenca 3.3; Evidencat 5.1-5.6).</i></p>		
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për këshillimin e studentëve të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” institucioni ka ngritur në nivel të njësisë kryesore (FShN) Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Specialistet e kësaj dege informojnë dhe këshillojnë studentët në mënyrë të vazhduar nëpërmjet takimeve personale dhe informacioneve të publikuara ose të shpërndara në rrugë elektronike.</p> <p>Stafi prej dy specialistesh i kësaj strukture përballon me vështirësi asistimin dhe këshillimin e numrit të madh të studentëve të fakultetit, prandaj njësi të tjera brenda fakultetit mbështesin informimin dhe këshillimin e studentëve, si stafi akademik dhe ndihmës akademik i departamenteve, pedagogët kujdestarë të kurseve, studentë Alumni, etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.19; Evidenca 3.3; Evidencat 5.1-5.6; Takimi me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës së FShN në bashkëpunim me DBT ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës mban kontakte me të diplomuarit dhe kontakton në mënyrë të vazhdueshme me ta, për të përditësuar bazën e të dhënave, për të ruajtur lidhjet e alumni-t me universitetin. Raportet që harton kjo degë i'u vihen në dispozicion Fakultetit dhe Departamenteve përkatëse për t'u analizuar.</p> <p><i>(Evidenca 1.16.2; Evidenca 1.17; Evidenca 6.4).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në dokumentin e tij strategjik Universiteti i Tiranës angazhohet për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij. Strukturat dhe parimet e funksionimit të këtyre strukturave janë sanksionuar në Statutin e UT. Në këtë kuadër, në nivel Universiteti është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), ndërsa në nivel fakulteti Dega/Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). KPSSC ka hartuar Rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe Planin e Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.13-1.15; Evidenca 3.11; Evidenca 6.1; Evidenca 6.2; Evidenca 6.3).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Struktura përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në FShN është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Kjo zyrë, siç e tregon edhe në emërtim, është përgjegjëse si për zbatimin e politikave dhe masave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ashtu edhe për këshillimin për karrierën. Në veprimtarinë e saj, DSBCK mbështetet në rregulloren e DSBCK (Ev 6.2) dhe përgjigjet për zbatimin e Planit të Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (plan veprimi i UT, për zbatim nga të gjitha njësitë kryesore të UT). (Ev 6.1). Në ndihmë të zbatimit të këtij plani, DSBCK shfrytëzon Paketën e Instrumentave për Sigurimin e Cilësisë në UT (Ev. 6.3). Studentët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve semestrale, pyetësorëve të vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogët, si edhe nëpërmjet pyetësorëve të pasdiplomimit.</p> <p>DSBCK harton raporte vlerësimi mbi bazë vjetore, të cilat përdoren si burim informacioni/të dhënash për raportet e vetëvlerësimit.</p> <p><i>GVJ gjykon se stafi prej vetëm dy specialistësh i DSBCK, megjithëse ka mbështetjen e Dekanatit dhe Departamenteve, përballon me vështirësi detyrat që lidhen si me zbatimin e Planit të Veprimit për Sigurimin e Cilësisë, ashtu edhe ato të asistimit dhe këshillimit të studentëve të FShN për karrierën.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.19; Evidenca 3.4-3.10; Evidenca 3.11; Evidenca 6.1-6.5; Takimi i GVJ me punonjëset e DSBCK, FShN)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe</p>	<p>Referuar nenit 104 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, dy prej instrumentave kryesorë për sigurimin e jashtëm të cilësisë në IAL janë akreditimi institucional dhe akreditimi i programeve të studimit, të cilat janë dhe detyrim ligjor për çdo IAL. Procesi i akreditimit periodik institucional të UT përfundoi me vlerësimin pozitiv dhe akreditimin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 66

<p>procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>institucional me kohëzgjatje prej 4 vitesh.</p> <p><i>(Evidenca 2.9; Ligji 80/2015).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në Statutin e UT janë përshkruar strukturat dhe procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen nga UT. Për të arritur objektivat për sigurimin e cilësisë, të shprehura në dokumentat e tij strategjikë, UT, në vitin 2020, ka miratuar në Senat Akademik “Rregulloren për sigurimin e cilësisë”, e cila përcakton procedurat dhe mekanizmat për sigurimin dhe garantimin e brendshëm të cilësisë. Koncretisht në FShN, struktura përgjegjëse për menaxhimin e brendshëm të cilësisë është DSBCK e cila bashkëpunon ngushtësisht me Zv.Dekanan për nivelin e parë dhe të dytë të studimeve dhe përgjegjësit e njëjësive bazë të FShN.</p> <p>UT dhe FShN inkurajojnë një proces gjithëpërfshirës në sigurimin e cilësisë. Në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin Bachelor në Bioteknologji përfshihen studentët, drejtuesi i DBT, stafi akademik i DBT dhe aktorë të tjerë të fushës akademike dhe administrative të angazhuar në këtë program. Për të ndërgjegjësuar dhe nxitur studentët për të marrë pjesë në anketime angazhohet edhe Këshilli Studentor i Fakultetit. DSBCK ndjek procedura periodike për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Veprimtaritë periodike të vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programit nga DSBCK konsistojnë në zhvillimin e pyetësorëve semestral dhe ato të pasdiplomimit, përpunimin dhe publikimin e rezultateve në raportet vjetore.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.13; Evidenca 6.1; Evidenca 6.3; Evidenca 6.4; Evidenca 3.5-3.8; Takimi me punonjëset e DSBCK, FShN; Takimi me Zv.Dekanan për Nivelin e I-rë dhe të II-të të Studimeve).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në nivelin e IAL, struktura përgjegjëse për shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit është Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. Veprimtaria e këtij komisioni rregullohet nga Rregullorja “Për ushtrimin e veprimtarisë së Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës të UT”. Ky Komision vlerëson propozimet për programet e studimit të paraqitur për shqyrtim nga njëjësia bazë dhe të përcjella nga njëjësia kryesore. Ky komision e kryen veprimtarinë e tij për garantimin e standardit të cilësisë së programeve të studimit dhe mbarëvajtjen e tyre në përputhje me misionin e UT, nevojat për specialistë në përputhje me kërkesat e tregut të punës si dhe kapacitetet akademike, infrastrukurore dhe financiare të njëjësive përgjegjëse për programin. Në FShN përgjegjëse për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e</p>

	<p>programit të studimit Bachelor në Bioteknologji është Zv.Dekani për nivelin e parë dhe të dytë të studimeve.</p> <p><i>(Evidenca 1.19; Evidenca 3.15; Takimi me zv.Dekanan për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së programit të studimit përdoren burime të ndryshme si: anketimet semestrale të studentëve për vlerësimin e lëndëve dhe mësimdhënies; anketimet e studentëve që diplomohen në lidhje me përmbushjen e pritshmërive të tyre nga programi i studimit; vetëvlerësimi i lëndës nga pedagogu, vlerësimi i performancës së stafit akademik; kontrolltet në lidhje me mbarëvajtjen e programit të studimit nga autoritetet drejtuese apo DSBCK. Rezultatet e anketimeve publikohen në formën e raporteve nga DSBCK. Procesi i anketimit është vullnetar dhe anonim. Të gjithë pyetësorët përpunohen dhe ruhen si hard copy nga DSBCK të FShN. Po kështu, vlerësimet dhe çdo aktivitet tjetër i kësaj njësie dokumentohet dhe ruhet në dosje të veçantë në DSBCK për çdo vit akademik.</p> <p>DSBCK e zhvillon aktivitetin e saj sipas një plani veprimi vjetor të miratuar paraprakisht në Dekanat. Ndryshimet në lidhje me programin e lëndëve të ndryshme dhe ndryshimet në programin mësimor (kur ato përbëjnë më pak se 20% të krediteve), me qëllim përshtatjen me kërkesat e kohës dhe arritjet e shkencës, si dhe ndryshimet që bëhen si reflektim ndaj planit të masave të propozuar nga DB, kryhen në respekt të rregullores së UT, DB dhe rregullores së programit të studimit. Ndryshimet diskutohen në Departament, konsultohen me Zv.Dekanan për studimet e ciklit të parë dhe të dytë, FShN, dhe miratohen në Dekanatin e FShN dhe Senatin e UT.</p> <p><i>(Evidenca 3.4 -3.10; Evidenca 6.2; Evidenca 6.4; Evidenca 6.9; Evidenca 6.11)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në FShN për vlerësimin e programit të studimit, të performancës së stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të përfshirë në këtë program, shfrytëzon instrumentat matës dhe vlerësues të publikuar në dokumentin “Paketa e instrumentave të cilësisë” të miratuar në Senatin Akademik të UT. Ndër instrumentat matës dhe vlerësues të mbarëvajtjes së programit të studimit përfshihen formularët e vlerësimit, formularët e vetëvlerësimit, pyetësorët, intervistat, fokus grupet, skedat e vrojtimit, etj. GVJ konstatoi se pikërisht këto “paketa instrumentash” të përshtatura shfrytëzohen nga DSBCK, FShN, për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve nga studentët, për vlerësimin e programit nga studentët e sapo diplomuar, për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit nga pedagogët, për vlerësimin e lëndës nga pedagogu përkatës, për vlerësimin e performancës së stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ nga përgjegjësi/punëdhënësi.</p> <p><i>(Evidenca 1.13-1.15; Evidenca 3.30; Evidenca 3.22; Evidenca 3.22.1; Evidenca 6.1; Evidenca 6.3; 3.6 -3.10).</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Bioteknologji bëhen pjesë e statistikave të publikuara dhe raporteve të hartuara nga DSBCK, të cilat i bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse për shqyrtim dhe reagim (DBT, Dekanatin të</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 68

programin e studimit.	<p>FShN). Pas analizës së tyre në departament, ky i fundit harton një plan masash për përmirësimin e cilësisë në hallka të caktuara të procesit akademik dhe kërkimor. Plani i masave shoqërohet me një plan veprimi, dokumente të cilat miratohen në Dekanatin e njësisë kryesore, përpara se të aplikohen. Nëse masat përfshijnë ndërhyrje në planin mësimor të programit deri në masën 20% të tij, atëherë ndryshimet miratohen në Senatin akademik të IAL. Nëse masat përfshijnë riorganizimin e programit të studimit (ndryshime në planin mësimor që kalojnë 20% të krediteve) atëherë aplikohet në MASR për riorganizimin e programit duke marrë paraprakisht miratimin e Departamentit, Dekanatit dhe Senatit Akademik. Ndikimi i masave të aplikuara në përmirësimin e cilësisë së programit, kontrollonhet gjatë zbatimit të tyre nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Zv.Dekani për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, si dhe vlerësohet me anë të instrumentave të cilësisë në vitin akademik pasardhës nga DSBCK.</p> <p><i>(Evidenca 6.4, Evidenca 6.11).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>DSBCK harton raporte semestrale të vlerësimit të procesit mësimor të programit të studimit dhe të lëndëve nga studentët dhe pedagogët, si edhe raporte vjetore të veprimtarisë së Degës. Në raportet e vlerësimit të programit të studimit prezantohen vetëm rezultatet e anketimeve, por mungon analiza e këtyre rezultateve. Raportet vjetore janë gjithashtu përshkrimore. Ato përshkruajnë veprimtarinë e DSBCK përgjatë një viti akademik.</p> <p>Analiza e rezultateve të anketimeve zhvillohet në Departament. Ky i fundit, duke adresuar dobësitë, harton një plan veprimi min. 1 vjeçar, për përmirësimin e cilësisë së programit dhe rezultateve të të nxëniet. Raportet vjetore të mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të departamentit përfshihen në raportet vjetore të FShN, të cilat bëhen publike...</p> <p><i>(Evidenca 1.16; Evidenca 1.27; Evidenca 6.4; Evidenca 6.11; Evidenca 3.5-3.10)</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë kryhet në mënyrë periodike për të gjitha programet e studimit të FShN nga DSBCK, përfshirë programin Bachelor në Bioteknologji. Vlerësimi i lëndëve dhe lektorëve përkatës kryhet çdo semestër, ndërsa vlerësimi i programit në tërësi kryhet çdo vit nga studentët e sapo diplomuar. Kontrolli i mbarëvajtjes kryhet nga autoritetet drejtuese në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Këto vlerësime përfshihen në Dosjet e Vetëvlerësimit që përgatiten në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 69




periodike.	kuadër të akreditimit institucional apo akreditimit të programit të studimit. <i>(Evidenca 2.8-2.9; Evidenca 3.4 – 3.10).</i>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Për kryerjen e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit UT ka ngritur struktura qëndrore si KPSSC dhe Komisionin e Kurrikulës dhe si dhe njësi të tyre në FShN - Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) dhe Dega Mësimore/e Kurrikulës në FShN. Njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në FShN përshtasin me natyrën e programeve të FShN instrumentet e vlerësimit të miratuar në dokumentat: Manuali i Sigurimit të Cilësisë, UT; Paketa e instrumentave të cilësisë, UT; Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik dhe atë të personelit ndihmës akademik. <i>(Evidenca 1.14; Evidenca 1.15; Evidenca 3.22; Evidenca 3.22.1)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	FShN dhe DBT, në funksion të sigurimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji”, përdorin disa metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies si: kontrollat e DSBCK/ dekanatit/ përgjegjësit të departamentit/ kryetarit të grupit mësimor-kërkimor për zhvillimin e procesit mësimor, ndjekjen e leksioneve, seanceve laboratorike, praktikave fishore, etj.; orët e hapura të leksioneve, mbrojtjes së detyrave të kursit; kontrolli i respektimit të programit të lëndës; vlerësimi i tezës së provimit nga komisioni i provimit dhe përgjegjësi i DB, ngritja e komisioneve të rivlerësimit me kërkesë të studentit. Vlerësimet e studentëve dhe pedagogëve nga IAL partnere në programet e shkëmbimit është një tjetër instrument i vlerësimit të cilësisë së programit. <i>(Evidenca 1.22, Evidenca 1.23; Evidenca 3.21; Evidenca 3.25; Evidenca 3.26; Evidenca 3.28).</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	FShN dhe Departamenti në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” përdor instrumente të tërthorta vlerësimi, siç janë anketimet. Studentët janë një grup interesi i rëndësishëm në vlerësimin e programit të studimit. Anketimet për vlerësimin përfshijnë studentët e tre kurseve të studimit të nivelit Bachelor, të cilët japin vlerësimin për lëndët dhe pedagogët në çdo semestër, si dhe studentët e sapo diplomuar, që japin vlerësimin për cilësinë e programit të studimit në tërësi nëpërmjet plotësimit të pyetësorit “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” dhe “Raporti studentit”. Mësimdhënia online gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 dhe vitit 2020-2021 gjithashtu u vlerësua nga studentët nëpërmjet anketimeve. Në anketimet mbi vlerësimin e lëndës, studentët në fund të çdo semestri, ata japin opinionet e tyre mbi përmbajtjen dhe organizimin e lëndës, metodat e mësimdhënies, mjedisin e të nxënit, burimet e të nxënit, cilësinë e mësimdhënies, vlerësim për pedagogun, etj. në anketimet e studentëve që diplomohen ata japin opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e arsimimit që kanë marrë në programin që kanë ndjekur, si dhe për nivelin e përgatitjes që që kanë fituar nga studimet. Në këto anketime studentët japin gjithashtu opinionin e tyre mbi aspektet pozitive të programit të studimit dhe aspektet, që sipas tyre, kërkojnë përmirësim. Rezultatet e anketimit të studentëve dhe analiza e tyre publikohen në raportet periodike të DSBCK, FShN.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@asca.al

Faqe 70




	<p>Edhe pedagogët marrin pjesë në vlerësimin e lëndëve përkatëse në çdo semestër. Në këto sondazhe pedagogët vlerësojnë përputhtjen e kurrikulës së lëndës me rezultatet e të nxënësve, efektshmërinë e metodës/ave të vlerësimit në lidhje me rezultatet e synuara të të nxënësve, si edhe japin opinionin e tyre për ndryshime/përmirësime, që mund të bëhen në kurrikulën e lëndëve ose në mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjetjet e këtyre vlerësimeve përmbledhen nga DSBCK në raportet semestrale të vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së programit kryhet edhe nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së statistikave të punësimit.</p> <p><i>GVJ gjykon se shfrytëzimi edhe i metodave alternative të vlerësimit indirekt, si p.sh. anketimet online, etj., do të rrisnin numrin e të anketuarve, do të shkurtonin kohën e përpunimit të informacionit dhe të daljes së rezultateve, dhe do të kursenin kohën e stafit të DSBCK.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.10; Evidenca 1.16; Evidenca 1.16.2; Evidenca 1.17; Evidenca 3.4-3.10).</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 716 782 806">Përmblidhet pjesërisht</th> <th data-bbox="782 716 997 806">Përmblidhet kryesisht</th> <th data-bbox="997 716 1204 806">Përmblidhet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 806 782 855"></td> <td data-bbox="782 806 997 855"></td> <td data-bbox="997 806 1204 855" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmblidhet pjesërisht	Përmblidhet kryesisht	Përmblidhet plotësisht			X
Përmblidhet pjesërisht	Përmblidhet kryesisht	Përmblidhet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në procesin e sigurimit të cilësisë, UT dhe FShN kanë përshtatur një qasje gjithëpërfshirëse. Në këtë proces përfshihen studentët, stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, strukturat/njësitë e sigurimit të cilësisë dhe strukturat drejtuese të institucionit. Me kërkesë të palëve të interesuara, për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit mund të përfshihen edhe aktorë të jashtëm të interesuar për procesin apo edhe ekspertë/kompani të jashtme me eksperiencë në fushën e sigurimit të cilësisë. Në statut sanksionohet se “nëpërmjet lirisë akademike, autonomisë financiare dhe organizative, UT lidh marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative”, duke mundësuar kështu përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. <i>Nuk ka evidenca të përfshirjes së aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> Ngritja e rrejtit Alumni UT, përveç të tjerave, do të mundësojë përfshirjen e një grupi aktorësh të jashtëm (ish studentëve të këtij programi studimi) në vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit Bachelor në Bioteknologji.</p> <p><i>(Evidenca 1.1; Evidenca 1.2; Evidenca 1.13; Evidenca 1.16.3).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për</p>	<p>Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT, përveç se përcakton strukturat e përfshira në proces, ajo përcakton edhe detyrat konkrete të të gjitha</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë



E-mail: info@asca.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.asca.al

Faqe 71

<p>njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>strukturave dhe palëve të interesuara në procesin e sigurimit të cilësisë. Në rregulloren për sigurimin e cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Po kështu, edhe në rregulloren e DSBCK, FShN, është përcaktuar përbërja dhe detyrat e DSBC dhe të GVB, të përfshira në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Grupet <i>ad hoc</i> të Vlerësimit të Brendshëm të cilësisë (GVB), që ngrihen në kuadër të akreditimit të programeve të studimit, kontribuojnë gjithashtu në vlerësimin e cilësisë. Megjithëse GVB kanë autonomi operacionale, këto grupe bashkëpunojnë dhe koordinohen me DSBCK. Studentët angazhohen në sigurimin e brendshëm të cilësisë përmes pjesëmarrjes së tyre në KPSSC dhe atë pjesëmarrjes në anketimet për vlerësimin e programit të studimit, lëndëve, lektorëve dhe stafit ndihmës e administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 6.1; Evidenca 6.23; Evidenca 6.3; Evidenca 6.6-6.8).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UT për sigurimin e cilësisë në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji” garanton përfshirjen e FShN dhe DBT, si edhe të stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në KPSSC dhe Komisionin e Kurrikulës. Nëpërmjet rregullores për sigurimin e cilësisë të UT dhe rregullores së DSBCK garantohet përfshirja e FShN dhe stafit akademik, ndihmës akademik të DBT, studentët e programit Bachelor në Bioteknologji dhe stafi administrativ që ka lidhje me këtë program në vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.19; Evidenca 1.13; Evidenca 3.15; Evidenca 6.2; RVB, Anekse, Tabela 24).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KPSSC dhe DSBCK si edhe strukturat akademike të përfshira në procesin e sigurimit të cilësisë, kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Studentët anëtarë të KPSSC të UT i’u garantohet e drejta e votës e barabartë me atë të çdo anëtar tjetër të komisionit. Këtë garanci i’a jep Statuti i UT dhe Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë në UT. Studentëve të përfshirë në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit i’u ruhet anonimati.</p> <p><i>(Evidenca 1.13; Evidenca 3.15; RVB, fq. 92).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit, në vlerësim janë përfshirë edhe palë të tjera të interesuara, siç janë ekspertë të jashtëm vendas dhe të huaj, ish studentë, përfaqësues të biznesit të fushës, përfaqësues të agjencive shtetërore, etj. Ekspertiza e tyre është e vlefshme në përshtatjen e programit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji” me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>(Evidenca 1.30).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Dokumentat strategjikë, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe të publikuara në faqen zyrtare të UT në adresën elektronike: <u>Akreditimi i programeve të studimit të UT-së – UNIVERSITETI I TIRANËS (unitir.edu.al)</u></p> <p>Veprimtaritë e DSBCK në FShN janë transparente dhe bëhen publike në faqen zyrtare të FShN në adresën: <u>https://fshn.edu.al/info/dega-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-dhe-karrieres</u></p> <p>Për të gjithë të interesuarit në faqen e mësipërme bëhen publike edhe raportet periodike të DSBCK në lidhje me sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që ofron FShN.</p> <p><i>(Evidenca 4.15).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit publikohen duke respektuar lirinë dhe etikën akademike në përputhje me Ligjin 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p><i>(RVB, fq. 94).</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së Programit Bachelor në Bioteknologji për vitin 2020-2021 janë shoqëruar me një plan masash që adresojnë dobësitë e evidentuara dhe synojnë përmirësimin/përshtatjen e programit të studimit, procesit mësimor e kërkimor me qëllim rritjen e cilësisë. Ky plan masash është hartuar nga DBT. Paketat e masave të propozuara në këtë dokument janë “përgjigje” për të përmirësuar dobësitë e programit, që dalë gjatë vlerësimit të brendshëm të cilësisë. <i>Në opinionin e GVJ plani i masave duhet të shoqërohet me veprime konkrete, afate kohore dhe koston e përafërt financiare.</i> Një prej këtyre masave është edhe përmirësimi i kurrikulës deri në masën 20% që prezantohet edhe në RVB. Analiza e rezultateve të vlerësimit prezantohet edhe në raportet vjetore të analizës së procesit mësimor dhe kërkimor të departamentit dhe fakultetit.</p> <p><i>(Evidenca 6.7; Evidenca 6.9; Evidenca 6.12; Evidenca 1.27; Evidenca 1.32).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Zbatimi i planit të masave, që është hartuar për të përmirësuar cilësinë e programit Bachelor në Bioteknologji, kërkon monitorim të efektivitetit të masave dhe eventualisht përshtatjen e tyre gjatë zbatimit. <i>Në planin e masave, ose edhe veçmas, mungon një plan monitorimi, gjë që e vështirëson vlerësimin e suksesit. Në rastin më të mirë, sukcesi i zbatimit do mund të vlerësohet pas një viti, kur të kryhet përsëri vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit nga DSBCK. Në raportin e analizës mësimore dhe kërkimore të DBT për vitin 2018-2019 (i vetmi i listuar në listën e referencave) mungon analiza e ndikimit të masave të marra në përmirësimin e cilësisë.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

Faqe 73




	<p><i>Pavarësisht se hartimi i planit të masave, si praktikë për përmirësimin e standardeve të cilësisë është prezantuar për këtë program në Shkurt 2022, përgjatë viteve pararendëse duhet të jenë aplikuar masa me ndikim të pritsëm në cilësinë e programit.</i></p> <p><i>(Evidenca 6.12; Evidenca 1.32).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në RVB nënvizohet se DSBCK organizon aktivitete dhe leksione informuese me personelin akademik dhe studentët, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për t'u përfshirë në vlerësimin e cilësisë së programit. .</p> <p><i>(RVB, fq. 95).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Bioteknologji” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. UT dhe FSHN ka një numër të madh projektsh Erasmus+ me anë të të cilëve mundësohet mobiliteti i personelit akademik për mësimdhënie si dhe e studentëve për të ndjekur semestra të tërë studimi pranë këtyre Universiteteve të huaja.
2. Departamenti ka laboratorë të mirëpajisur për kryerjen e praktikave laboratorike të avancuara të nivelit, molekular dhe citologjik.
3. Mbështetja financiare nga Fakulteti për projekte të propozuara nga stafi akademik i Departamentit të Bioteknologjisë, pjesëmarrja e stafit në projekte kërkimore shkencore dhe pajisja e laboratorëve me anë të këtyre projekteve.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e rregullores së Fakultetit (**Standardi I.4, kriteri 2**).
2. Mungesa e një sistemi elektronik vlerësimi (**Standardi III.6, kriteri 2**).
3. Në planin e masave të hartuar nga Departamenti për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, ose edhe veçmas, mungon një plan monitorimi, gjë që vështirëson vlerësimin e suksesit, si dhe në raportin e analizës mësimore dhe kërkimore mungon analiza e ndikimit të masave të marra në përmirësimin e cilësisë. (**Standardi VI.5, kriteri 4**).

Rekomandime:

1. Institucioni, të marrë masa për vendosjen e një sistemi elektronik vlerësimi, me qëllim eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit dhe rritjes së transparencës (**Standardi III.6, kriteri 2**).
2. Institucioni, të vijojë hapat e ndërmarra për hartimin e rregullores së fakultetit dhe ta miratojë e verë në zbatim atë sa më shpejt (**Standardi I.4, kriteri 2**).
3. Departamenti, të përfshijë në planin e masave për përmirësimin e cilësisë së programit, ose në një dokument të veçantë, edhe një plan monitorimi për vlerësimin e ecurisë së masave dhe suksesit të tyre, si dhe të përfshijë në raportin e analizës mësimore dhe kërkimore edhe një analizë të ndikimit të masave në përmirësimin e cilësisë (**Standardi VI.5, kriteri 4**).
4. Institucioni, të rishikojë parashikimet në aktet e brendshme rregullatore (Statut, Rregullore Diplomimi, Rregullore Programi) lidhur me përmbylljen e detyrimeve të programit dhe diplomimin e studentëve, në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet tyre (**Standardi V.2, kriteri 4**).
5. Institucioni, të konsiderojë mundësinë e pajisjes së sallave të studimit në bibliotekë me më shumë kompjutera me akses në internet, në mënyrë që ti jepet mundësia të gjithë studentëve për të kërkuar dhe shfrytëzuar literaturën dhe periodikët on-line (**Standardi IV.4, kriteri 4**).

**Conclusion of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in
"Biotechnology", of University of Tirana**

Strengths and Affirmations:


1. UT and FSHN have a large number of Erasmus+ projects through which the mobility of academic staff for teaching as well as of students to attend entire semesters of study at these foreign Universities is enabled.
2. The department has well-equipped laboratories for performing advanced level of molecular and cytological laboratory practices.
3. Financial support from the Faculty for projects proposed by the academic staff of the Department of Biotechnology, staff participation in scientific research projects and equipping laboratories through these projects.

Weaknesses:

1. The absence of Faculty regulation (**Standard I.4, criterion 2**).
2. The lack of an electronic assessment system (**Standard III.6, criterion 2**).
3. In the plan of measures drawn up by the Department for improving the quality of the study program, or even separately, a monitoring plan is missing, which makes it difficult to evaluate success, as well as in the report of the teaching and research analysis, the analysis of the impact of the measures taken, in quality improvement is missing (**Standard VI.5, criterion 4**).

Recommendations:

1. The institution should continue the steps taken to draft the faculty regulation and approve and implement it as soon as possible (**Standard I.4, criterion 2**).
2. The institution should take measures to establish an electronic assessment system, with the aim of eliminating various forms of abuse and increasing transparency (**Standard III.6, criterion 2**).
3. The department should include in the plan of measures for improving the quality of the program, or in a separate document, a monitoring plan for evaluating the progress of the measures and their success, as well as include in the report of the teaching and research analysis, an analysis of the impact of measures on quality improvement (**Standard VI.5, criterion 4**).
4. The institution should review the provisions in the internal regulatory acts (Statute, Graduation Regulations, Program Regulation) regarding the completion of program obligations and the graduation of students, in order to be in accordance (**Standard V.2, criterion 4**).
5. The institution should consider the possibility of equipping study rooms in the library with more computers with Internet access, so that all students are given the opportunity to search and use literature and periodicals online (**Standard IV.4, criterion 4**).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS		
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X
VLERËSIMI TËRËSOR			X